



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në:  
“Mësues i Gjuhës Angleze”  
Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof. Dr. Elida TABAKU**

**Dr. Rudina VRIONI**

**Prill / 2024**

## **TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

### **Master Profesional në "Mësues i Gjuhës Angleze"**

1	IAL aplikues:	Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Gjuhëve të Huaja
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në "Mësues i Gjuhës Angleze"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASH Nr.430, datë 07.09.2012
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendim Senati Nr. 66, datë 14.06.2018 Miratuar nga MASR me shkresë, 7238/1 prot, date 31.08.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 297, datë 22.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 (dy) vite akademike / 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht / Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	9 PAE / 3 PAK
18	Numri i studentëve:	v. a. 2020 – 2021...78 studentë; v. a. 2021 – 2022...66 studentë; v. a. 2022 – 2023...57 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit Master Profesional "Mësues i Gjuhës Angleze" ofrohet nga Universiteti "Aleksandër Moisiu", një institucion publik i arsimit të lartë, i themeluar me VKM, Nr.801, datë 20.12.2005, dhe që për herë të parë i hapi dyert për një mijë student, gjatë vitit akademik 2006-2007, me tre njësi kryesore: Fakulteti i Ekonomisë dhe Administrimit, Fakulteti i Edukimit dhe një Shkollë e Lartë Profesionale. UAMD është riorganizuar sipas Vendimit numër 685, dt 25.08.2010 në 5 fakultete të cilat janë edhe njësitë kryesore aktuale të Institucionit konkretisht:

1. Fakulteti i Biznesit;
2. **Fakulteti i Edukimit;**
3. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit;
4. Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike;
5. Fakulteti i Studimeve Profesional;

Për t'iu përgjigjur nevojave të tregut shqiptar për mësues të gjuhës angleze, Ministria e Arsimit dhe Shkencës me Urdhër Nr.430, datë 07.09.2012 lejoi hapjen e programit të studimeve të ciklit të dytë, 'Master Profesional' në 'Mësimdhënien e Gjuhës Angleze'. Që nga fillimet e tij, ky program ka pësuar ndryshime të qënësishme. Programi i studimit të ciklit të dytë 'Master Profesional' në 'Mësues i Gjuhës Angleze' pas riorganizimit sipas Udhëzimit Nr.31, datë 29.12.2017 të MASR dhe sipas Vendimit të Senatit Nr. 66, datë 14.06.2018, miratuar me shkresë nga MASR Nr. 7238/1 Prot., datë 31.08.2018 ndryshoi nga një program me një kurrikul me 90 kredite (1.5 vite akademike) në një kurrikul me 120 kredite të shtrira në dy vite akademike si dhe ndryshimin e emërimit në Master Profesional "Mësues i Gjuhës Angleze". Qëllimi kryesor i programit është të përgatisë mësues të gjuhës angleze, të aftë për të ushtruar profesionin e mësuesit dhe për të nxënë gjatë gjithë jetës, të aftë për t'iu përgjigjur kërkesave të reja të tregut dhe zhvillimeve ekonomike dhe shoqërore në vend, duke i pajisur studentët me njohuri të qëndrueshme dhe aftësi jo vetëm në fushën e mësimdhënies por edhe në përdorimin e mjeteve të reja teknologjike brenda dhe jashtë procesit mësimor. Programi është i orientuar drejt ndërthurjes me kujdes të pjesës teorike që zhvillohet në auditor me praktikën e zhvilluar në institucionet e arsimit parauniversitar në përputhje me marrëveshjet e vazhdueshme që programi ka me Drejtoritë Arsimore Rajonale në Durrës dhe më gjerë. Për të siguruar cilësi programi bazohet vazhdimisht në përvojën më të mirë të universiteteve shqiptare dhe atyre europiane brenda kuadrit të Procesit të Bolonjës. Programet e mobilitetit ku janë përfshirë stafi dhe studentët e këtij programi kanë dhënë ndihmesën tyre në këtë drejtim.



## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Procesi i vlerësimit të programit të ciklit të dytë të studimeve “Master Profesional” në “Mësues i Gjuhës Angleze” filloi me hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm nga një grup prej gjashtë anëtarësh prej të cilëve katër janë personel akademik, një personel ndihmës-akademik dhe një student. GVB u ngrit pas Vendimit të Dekanatit të Fakultetit të Edukimit Nr. 916, datë 30.05.2023, në përputhje me dispozitat ligjore të MAS dhe Statutin e UAMD-së. GVB organizoi ndarjen e punës për mbledhjen e dokumentacionit dhe hartimin e raportit, në bashkëpunim me stafin akademik, sekretaritet mësimore dhe zyrat në mbështetje të studentëve dhe veprimtarisë akademike në institucion. Grupi është përqëndruar në gjykimin e 6 fushave kryesore, të cilat janë analizuar mbi bazën e dokumentacionit të siguruar në nivel universiteti, fakulteti, dhe programi të studimit. Raporti i vlerësimit të brendshëm është i shoqëruar nga një dosje prej 135 evidencash mbështetëse që përfshijnë kuadrin ligjor, menaxhimin institucional dhe administrimin e këtij programi, rregulloret dhe planet strategjike të zhvillimit, stafin akademik dhe studentët, objektivat e programit dhe rezultatet e të nxënit, aktorët mbështetës, sigurimin e cilësisë dhe administrimin financiar dhe infrastrukturor në dispozicion të tij. Shkrimi i RVB reflekton profesionalizëm, kujdes në analizën e përmbushjes së standardeve dhe vëmendje në pasqyrimin konkret të gjetjeve në pjesën përshkruese. GVB reflektoi se njih mirë gjendjen dhe ka bërë një vlerësim objektiv të saj gjatë vizitës në institucion të GVJ edhe gjatë takimit dhe diskutimeve me GVJ. ASCAL, bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga institucioni, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: **Prof.Dr. Elida Tabaku** dhe **Dr. Rudina Vrioni**. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga koordinatori teknik i ASCAL, **Znj. Majlinda Demirneli**. Vizita në institucion u krye në datat 08-09 tetor 2023. Gjatë kesaj vizite GVJ organizoi takime me dekanen e FE dhe përgjegjësen e departamentit të gjuhëve të huaja, grupin e vlerësimit të brendshëm dhe NJBSC, stafin akademik dhe studentët, stafin administrativ në shërbim të studentëve, përfaqësues të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Drejtorisë së Marrëdhënieve me jashtë dhe Projekteve. GVJ kreu gjithashtu vizitën në ambientet në dispozicion të mësimdhënies dhe të nxënit për këtë program studimi, sekretarinë mësimore, bibliotekën e Fakultetit dhe sallat e mësimi. Pas vizitës në institucion, GVJ krijoi ide më të qarta në lidhje me përgjegjësitë, procedurat, organizimin dhe menaxhimin e programit të studimit dhe burimeve njerëzore në dispozicion të tij dhe arriti në konstatimet e mëposhtme, të hartura në formën e këtij raporti të vlerësimit të jashtëm.

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 23.02.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 19/39 Prot, datë 23.02.2024. Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës nuk ka dërguar komente, sugjerime në lidhje mbi Draft Raportin, sipas Manualit 2017, si dhe përcaktimit në agjendën e detajuar të vlerësimit. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës dhe Fakulteti i Edukimit, si një nga njësitë kryesore të tij ofron një numër të madh programesh studimi në fushën e edukimit duke synuar arritjen e standardeve akademike më të larta kombëtare dhe ndërkombëtare. Programi i studimit “Master Profesional” në “Mësues i Gjuhës Angleze” që ofron UAMD është ndërtuar duke respektuar Ligjin për Arsimin e Lartë dhe të gjithë bazën ligjore në fuqi. Misioni dhe qëllimi i programit përputhen me Statutin dhe Planin e Zhvillimit Strategjik të UAMD-së. UAMD ka si qëllim të ruajë dhe të konsolidojë vlerat akademike e kulturore kombëtare.  Evidencë. 3- Statuti UAMD, 2018.pdf  Evidencë 4-Plani i Zhvillimit Strategjik UAMD, 2020-2025.pdf)
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit “Master Profesional” në “Mësues i Gjuhës Angleze” u hap me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr.430, datë 07.09.2012 dhe është në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit si dhe fushën e veprimtarisë së tij. Ofrimi i këtij programi studimi synon në përgatitjen e mësuesve të aftë në mësimdhënien e gjuhës angleze sipas standardeve ndërkombëtare bashkëkohore.  Evidencë. 3- Statuti UAMD, 2018.pdf,  Evidencë.4-Plani i Zhvillimit Strategjik UAMD, 2020-2025.pdf, Evidencë.14-Strategjia e Departamentit të Gjuheve të Huaja, 2020-2025.
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në	Bazuar në dokumentacionin e shtyrtuar GVJ konstaton se PS “Master Profesional” në “Mësues i Gjuhës Angleze” është hartuar dhe ofrohet në zbatim të drejtimeve prioritare akademike,

<p>zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>të cilat janë të përcaktuara qartë në Statutin e UAMD, si dhe në Planin e Zhvillimit Strategjik të Institucionit dhe të Rregullores së UAMD. Ky program është në përputhje me objektivat e Departamentit të Gjuhëve të Huaja dhe me vizionin e tij, që është ai i njohjes kombëtarisht dhe ndërkombëtarisht si një institucion që përgatit specialistë të aftë në fushën e gjuhës angleze si ekspertë të aftë në mësimdhënie dhe pjesëtarë aktivë të komunitetit.</p> <p>Evidencë. 3- Statuti UAMD, 2018.pdf</p> <p>Evidencë.5-Rregullore UAMD)</p> <p>Evidencë.14-Strategjia e Departamentit të Gjuheve të Huaja, 2020-2025.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>GVJ konstaton se PS “Master Profesional” në “Mësues i Gjuhës Angleze” është hartuar në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit të arsimit të shprehura në Planin Strategjik të Zhvillimit të UAMD, Strategjinë e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, 2020-2025. Programi është hartuar në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi që rregullojnë funksionimin e programit mësimor. Ai zhvillohet për të plotësuar nevojat e e tregut për specialistë në fushën e mësimdhënies së gjuhës angleze.</p> <p>Evidencë. 1- Mendimi i dekanit</p> <p>Evidencë. 5 -Rregullore UAMD</p> <p>Evidencë.14-Strategjia e Departamentit të Gjuheve të Huaja, 2020-2025</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja, vëren se program i studimit “Master Profesional” në “Mësues i Gjuhës Angleze” është hartuar dhe ofrohet në përputhje të plotë me misionin dhe qëllimet e UAMD.</i></p> <p><i>Fusha akademike dhe kërkimore e programit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë që e ofrojnë këtë program. Programi i studimit kontribuon në ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare. Nisur nga sa u tha më lart GVJ konstaton se ku standard përmbushat plotësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>



X

**Standardi I.2**

**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																		
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>PS “Master Profesional” në “Mësues i Gjuhës Angleze” ofrohet nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja, njësi bazë e FE. FE, si njësi kryesore e UAMD-së ka kapacitetet dhe burimet e nevojshme për të ofruar një program cilësor në drejtimin mësuesi. FE përbëhet nga gjashtë departamente. Në Departamentin e Gjuhëve të Huaja i cili është përgjegjës për programin e studimit, për vitin akademik 2022 – 2023 janë 22 staf akademik efektiv dhe 25 staf akademik me kontratë, të cilët zotërojnë kualifikimin si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="584 976 1382 1323"> <thead> <tr> <th>Kualifikimi</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr.</td> <td>-</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>4</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr./PhD</td> <td>13</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>5</td> <td>19</td> </tr> <tr> <td><b>Total</b></td> <td><b>22</b></td> <td><b>25</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>Kualifikimi i stafit përkon me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë dhe me profilin e lëndëve që zhvillojnë pedagogët.</p> <p>Evidencë. 15-Rregullore, Master Profesional Mësues i Gjuhës Angleze</p> <p>Evidencë. 54-Ngarkesa Mësimore e Personelit Akademik në të Gjitha Programet, 2021-2022.</p>	Kualifikimi	PAE	PAK	Prof. Dr.	-	1	Prof. Asoc.	4	-	Dr./PhD	13	5	Msc	5	19	<b>Total</b>	<b>22</b>	<b>25</b>
Kualifikimi	PAE	PAK																	
Prof. Dr.	-	1																	
Prof. Asoc.	4	-																	
Dr./PhD	13	5																	
Msc	5	19																	
<b>Total</b>	<b>22</b>	<b>25</b>																	
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe rregulloreve të DGjH dhe të FE konstatojmë se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit “Master profesional” në “Mësues i Gjuhës Angleze” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Edukimit të përcaktuar në Rregulloren e FE. Misioni i FE është përgatitja e individëve të kualifikuar në shkencën e arsimit dhe</p>																		




<p>kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>në fusha të ngjashme me to. Hartimi dhe zbatimi i programit të studimit është në përputhje me kodifikimin e programit të studimit sipas klasifikimeve kombëtare e udhëzimeve kombëtare e Europiane. Programi ofron kualifikim të nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Fusha e përgjithshme dhe specifike e këtij programi qëndron brenda kornizës së fushës akademike dhe kërkimore të FE. Në kodifikim përcaktohet përputhja e programit me fushën e gjerë, kodi 01 Arsimit dhe fushën e ngushtë, kodi 011 Arsim. FE ofron programe studimi të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe Sistemin Amerikan UsCr. Njësia kryesore ofron edhe diploma profesionale, sipas nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</p> <p>Evidencë. 1- Mendimi i dekanit</p> <p>Evidencë.9-Rregullore FE.</p> <p>Evidencë. 15-Rregullore, Master Profesional Mësues i Gjuhës Angleze</p> <p>Evidencë.. 17-Lista e Programeve UAMD</p> <p>Evidencë. 18 -Kodifikimi i Programeve UAMD</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Ky PS ofrohet nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja, përgjegjës për zbatimin e këtij programi studimi. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje të plotë me fushën akademike e kërkimore të DGJH.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit,</p>	<p>Ky PS ofrohet nga FE dhe DGjH dhe është në përputhje të plotë me profilin e tyre.</p>



cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.									
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	UAMD ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. Nëpërmjet Qendrës për Edukim në Vazhdim organizon Workshop-e, e veprimtari të ngjashme. Këto veprimtari i ndihmojnë studentët e diplomuar për përmirësimin e aftësive profesionale. Në bashkëpunim me Drejtorinë arsimore dhe me shkollat e rajonit realizohet kualifikimi i mëtejshëm i mësuesve të gjuhës angleze.								
<b>Konkluzione</b>	<i>PS "Master Profesional" në "Mësues i Gjuhës Angleze është në përputhje me fushën akademike të FE. Ky program synon të përgatisë mësues të gjuhës angleze.</i>  <i>Njësia bazë që ofron këtë PS ka kapacitetet e duhura njerëzore për të mirëmenaxhuar këtë program.</i>  <i>Hartimi dhe zbatimi i programit të studimit është në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret në fuqi. Ky standard përmbushet plotësisht.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi I.3

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së	Për vlerësimin e këtij kriteri GVJ u mbështet në shqyrtimin e RVB, statutin dhe rregulloren e UAMB dhe rregulloret përkatëse. Ky program është ndërtuar dhe funksionon në përputhje me këto rregullore. Rregullorja institucionit, e njësisë kryesore e njësisë bazë, rregullorja e programit të Masterit si dhe udhëzimet e lëshuara kanë përcaktuar qartë rolin dhe detyrat e aktorëve të programit, duke siguruar mbarëvajtjen e programit. Duke ju referuar analizës mësimore vjetore të punës së njësisë, si dhe takimeve me përfaqësues të departamentit dhe strukturave të




<p>përgjegjësi përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>institucionit konstatojmë se ka një bashkëpunim dhe bashkërendim të veprimtarisë midis këtyre stukturave, që i shërben përmirësimit të punës në lidhje me zbatimin e programit të studimit.</p> <p>Evidencë.5-Rregullore UAMD</p> <p>Evidencë.9-Rregullore FE</p> <p>Evidencë.12-Rregullore e Departamentit</p> <p>Evidencë. 5-Rregullore, Master Profesional Mësues i Gjuhës Angleze</p> <p>Evidencë.38-UdhëZIM nr.31, dt. 29.12.2017 për Riorganizimin e Programeve të Studimit</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Sipas dokumentave në dosjen e Vetëvlerësimit dhe takimeve me përfaqësuesin e zyrës së marrëdhënieve me jashtë dhe të projekteve, GVJ konstaon se UAMD punon sistematikisht për realizimin e objektivave të procesit mësimor duke vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet brenda dhe/ose jashtë vendit, si dhe aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. Institucioni ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh (mbi 90) me institucione arsimore vendase dhe të huaja. Përcaktimi i objektivave të qarta në Strategjinë e Ndërkombëtarizimit të UAMD kanë ndihmuar në një veprimtari më të organizuar në këtë drejtim Është nxitur dhe siguruar bashkëpunimi me universitete të ndryshme në BE.</p> <p>Evidencë. 2- Strategjia e Ndërkombëtarizimit të UAMD</p> <p>Evidencë. 66-Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD-s</p> <p>Evidencë. 123 Shkembime student Erasmus</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon</p>	<p>Nga shqyrtimi i Dosjes së Vëtvlerësimit GVJ kostaton se për realizimin e praktikës profesionale, pjesë e rëndësishme këtij PS, FE ka nënshkruar marrëdhënie bashkëpunimi me Drejtoritë Arsimore Rajonale Durrës. DGjH ndjek në mënyrë të organizuar praktikën profesionale të studentëve të programit master.</p> <p>Evidencë.77-Marrëveshje Bashkëpunimi me DAR</p> <p>Evidencë. 131- Ndarja e Praktikës në Departament.2021-2022</p> <p>Evidencë. 132-Dosja e Praktikës MP “Mësues i Gjuhës Angleze</p>




me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.				
<b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	<p>GVJ konstaton se DGjH, si njësia përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit Master Profesional "Mësues i Gjuhës Angleze", ndjek në vazhdimësi zhvillimin e praktikës profesionale dhe harton raporte analitike në mënyrë të vazhdueshme mbi rezultatet dhe përfitimet që vijnë nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. Gjatë takimit me studentë të programit master dhe me pedagogë të departamentit GVJ u informua për përfitimet profesionale nga organizimi i praktikës dhe bashkëpunimi me shkollat pritëse. Ato kanë vënë në dukje efektet pozitive dhe përfitimet e këtyre marrëveshjeve në tërësi në funksion të realizimit të qëllimeve të këtij PS, si dhe janë evidentuar mangësitë.</p> <p>Evidencë.79-Analiza Vjetore e Njesisë Bazë në lidhje me MP "Mësues i Gjuhës Angleze"2020-2021</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>UAMD punon sistematikisht për realizimin e objektivave të procesit mësimor, duke treguar vëmendje për aftësimin profesional të stafit dhe studentëve, kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimit të institucionit, duke vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet brenda dhe jashtë vendit, që tregohet nga numri i marrëveshjeve të arritura.</i></p> <p><i>FE ka lidhur marrëveshje me DAR Durrës për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve të këtij programi, praktikë që ndiqet në mënyrë të organizuar nga DGjH dhe që është objekt analize përfitimet nga marrëveshjet dhe bashkëpunimet. GVJ arrin në përfundimin se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X




Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregulatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze” është në përputhje të plotë me dispozitat e legjislacionit vendas në fuqi për arsimin e lartë (Ligji 80/2015 dhe VKM nr.41, dt.24.01.2018).</p> <p>Ky program zbatohet në vijueshmëri me specifikimet e Rregullores së Departamentit dhe të Programit të Studimit. Plani mësimor i programit reflekton ndarjen e lëndëve dhe moduleve përkatëse sipas kategorive lëndore dhe pasqyron ngarkesën e tyre në kredite për teori dhe praktikë, në orë të studimit në auditor dhe orë të studimit individual. Programi ka 18 lëndë, praktikën dhe tezën e diplomimit, të cilat pasqyrohen në planin Mësimor, ku shënohen kreditet përkatëse, tipologjia e lëndës, koha e zhvillimit të tyre, ngarkesa semestrale etj.</p> <p>Evidencë.129-Kurrikula Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2022-2024</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës,</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze” është hartuar në përputhje me objektivin kryesor përgatitjen e specialistëve të mësimdhënies së gjuhës angleze për të gjithë nivelet e arsimit parauniversitar.</p> <p>Nëpërmjet këtij programi, lëndëve dhe moduleve të përfshira në planin mësimor, studentëve ju jepen njohuri në fushat e edukimit të përgjithshëm, të mësimdhënies së gjuhës së huaj, të edukimit ndërkulturor, aftësi të aplikimit të teknologjisë së informacionit në mësimdhënien e gjuhës angleze, si dhe zhvillohen aftësitë e tyre të përdorimit të gjuhës e huaj, si dhe aftësi të punës</p>



<p>zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>kërkimore. Programi gërsheton aspektin teorik me atë praktik, si në lëndë të veçanta ashtu edhe nëpërmjet zhvillimit dhe ndjekjes së praktikës profesionale. Në secilin vit akademik bëhet përditësimi i syllabuseve dhe i literaturës duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së studentëve dhe aftësimin e tyre të mëtijshëm në mësimdhënien e gjuhës angleze si gjuhë e huaj.</p> <p>Evidencë.37-Dosja e Plotë e Masterit Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze” pas Riorganizimit, 2018-2019</p> <p>Evidencë.124-Syllabuset e Lëndëve</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze” ka përcaktuar ngarkesën për praktikën profesionale me 12 kredite. Plani mësimor parashikon të zhvillohet në semestrin e katërt të zgjatjes së programit, të ndarë ndërmjet 75 orëve në auditor dhe 25 orëve në institucione të ndryshme arsimore të sektorit publik ose privat.</p> <p><i>GVJ konstaton se planifikimi i praktikës profesionale duhet të rishikohet në favor të orëve të zhvilluara në institucionet arsimore, sepse orët në ambientet e shkollave zënë vetëm 25 % të kohës së planifikuar.</i></p> <p>Detyrimet përmbyllëse kanë një ngarkesë prej 18 kreditesh, ose 15% të planit. Ngarkesa e këtyre komponentëve mësimorë është në përputhje me VKM nr.41, dt.24.01.2018.</p> <p>Evidencë.130-Rregullore e Praktikës, 2019</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësimi i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Mësues i Gjuhës së Huaj” është organizuar në përputhje të plotë me kërkesat e VKM nr.41, dt.24.01.2018 për programet e ciklit të dytë të studimit Master në mësuesi, duke përfshirë veprimtari formuese të vlerësuara në kredite dhe që i përkojnë lëndëve të formimit të përgjithshëm, të përgatitjes metodologjike, lëndë që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik për mësuesin e gjuhës angleze, dhe grup-lëndë me zgjedhje; praktikat profesionale dhe detyrime përmbyllëse. Ky program mundëson formimin e mësuesve të rinj më aftësi të mira gjuhësore, njohuri e aftësi psikopedagogjike, njohuri e aftësi në metodikën e mësimdhënies e gjuhës angleze si gjuhë e huaj, edukimin ndërkulturor si dhe aftësi për të bërë kërkime në fushën e arsimit. Evidencë.37-Dosja e Plotë e Masterit</p>




	Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze” pas Riorganizimit, 2018-2019
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Programi i studimit MP “Mësues i Gjuhës Angleze” është organizuar me 120 kredite nga të cilat 25% janë për formimin e përgjithshëm psikopedagogjik. Lëndët/modulet janë të grupuara sipas kategorive me këtë raport kreditesh:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Lëndë bazë – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme. A- 10 kredite ( 8.1 %- standardi 5-10%)</li> <li>2. Lëndë karakterizuese. B- 45 kredite (38.5%-standardi 30-40%)</li> <li>3. Lëndë ndërdisiplinore/integruese. -35 kredite (28.4%-standardi 20-30%)</li> <li>4. Lëndë plotësuese, praktika profesionale. D - 12 kredite (10% -standardi 10%)</li> <li>5. Detyrime plotësuese. E -18 kredite (15%-standardi 10-12 % )</li> </ol> <p>Nga shqyrtimi i lëndëve të përfshira në planin mësimor GVJ konstaton se 25 % e krediteve, 30 kredite, janë në shërbim të formimit psikopedagogjik të studentëve. GVJ vlerëson se kjo kurrikul ka një përqindje të lartë të përafërt me kurrikulat e Programeve “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë. Është e përafërt me kurrikulën e FGjH UT ( plani mësimor në faqen zyrtare te FGjH ,UT)</p> <p>Evidencë .129-Kurrikula Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2022-2024<a href="https://fgjh.edu.al/master-i-shkencave-nemuesesi-e-gjuhes-angleze-per-arsimin-e-mesem-te-larte/">https://fgjh.edu.al/master-i-shkencave-nemuesesi-e-gjuhes-angleze-per-arsimin-e-mesem-te-larte/</a></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>PS i studimit Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze” përmban të gjitha elementet që përcaktojnë format e organizimit të studimeve dhe pranimit të studentëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore.</p> <p>Evidencë.5-Rregullore UAMD, Neni 42, 45</p> <p>Evidencë.9-Rregullore FE, 2019. Seksioni IV, 24</p> <p>Evidencë.15-Rregullore, Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2019-2020</p> <p>Evidencë.37-Dosja e Plotë e Masterit Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze” pas Riorganizimit, 2018-2019</p>



<p><b>Kriteri 7.</b> Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit MP në “Mësues i Gjuhës Angleze” është në përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 80 për qind, me programet që ofrohen në të njëjtën fushë studimi. Kjo vihet re nga krahasimet që janë bërë me kurrikulën e Master në Mësuesi të UT .</p> <p><a href="https://fgjh.edu.al/master-i-shkencave-ne-mesuesi-e-gjuhes-angleze-per-arsimin-e-mesem-te-larte/">https://fgjh.edu.al/master-i-shkencave-ne-mesuesi-e-gjuhes-angleze-per-arsimin-e-mesem-te-larte/</a></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Në raportin e vlerësimit të brendshëm si dhe në zbatim të udhëzimeve përkatëse nga ana e Ministrisë së Arsimit UAMD ka hartuar një kodifikim të brendshëm të programeve dhe programi MP në “Mësues i Gjuhës Angleze” mban kodin UAMD-MPS-70114-MGJA. GVJ konstaton se kodifikimi i lëndëve të programit nuk është kryer ende.</p> <p>Evidencë. 18-Kodifikimi i Programeve UAMD</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>DGjH nuk ofron programe të përbashkëta me asnjë institucion të arsimit të lartë vendas dhe të huaj. Programi i studimit Master Profesional në “Mësues i Gjuhës Angleze” realizohet plotësisht nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja pranë FE.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi i studimit Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze” është hartuar dhe zbatohet në përputhje të plotë me dispozitat e legjislacionit vendas në fuqi për arsimin e lartë. Fusha e përgjithshme dhe specifike e PS të MP “Mësues i Gjuhës Angleze” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të FE, të përcaktuar në Rregulloren e FE. Ai siguron realizimin e objektivit kryesor të PS të MP .</i></p> <p><i>Një sërë rregulloresh të miratuara sigurojnë realizimin e këtij programi. Plani mësimor i programit është i ndarë në veprimtari formuese të vlerësuara në kreditë dhe respektohet raporti i ndarjes së lëndëve të kategorive të ndryshme. Programi është afërsisht 80 % i përafërt me programet që ofrohen në të njëjtën fushë studimi.</i></p>

	<i>Mbështetur në sa më sipër GVJ konstaton se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.2</b>																					
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>																					
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>																				
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjisllacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të paraqitur në DVV Fakulteti i Edukimit, si njësia kryesore, dhe Departamenti i Gjuhëve të Huaja, si njësia bazë, janë përgjegjëse për programin e studimit MP “Mësues i Gjuhës Angleze” dhe përmbushin të gjitha detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. FE ka në përbërje gjashtë njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Pedagogjisë;</li> <li>2. Departamenti i Gjuhës Shqipe;</li> <li>3. Departamenti i Letërsisë;</li> <li>4. <b>Departamenti i Gjuhëve të Huaja;</b></li> <li>5. Departamenti i Sociologjisë;</li> <li>6. Departamenti i Psikologjisë;</li> <li>7. Qendra e Edukimit në Vazhdim;</li> </ol> <p>Fakulteti i Edukimit, si Njësia Kryesore për programin e studimit për vitin akademik 2022-2023 ka gjithsej 125 pedagogë, nga të cilët 79 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 46 pedagogë me kontratë (PAK), me kualifikimin e mëposhtëm:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th> <th colspan="2">Fakulteti i Edukimit</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>3</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof.Asoc</td> <td>19</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>52</td> <td>7</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>5</td> <td>34</td> </tr> <tr> <td><b>Gjithsej</b></td> <td><b>79</b></td> <td><b>46</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit MP “Mësues i Gjuhës Angleze” në UAMD është Departamenti i Gjuhëve të</p>	Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Edukimit		PAE	PAK	Prof.Dr	3	1	Prof.Asoc	19	4	Dr/PhD	52	7	Msc	5	34	<b>Gjithsej</b>	<b>79</b>	<b>46</b>
Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Edukimit																				
	PAE	PAK																			
Prof.Dr	3	1																			
Prof.Asoc	19	4																			
Dr/PhD	52	7																			
Msc	5	34																			
<b>Gjithsej</b>	<b>79</b>	<b>46</b>																			

	<p>Huaja. Referuar të dhënave të RVB, GVJ konstaton se kjo njësi bazë përmbush kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit akademik të brendshëm (PAE) dhe atë me kontratë (PAK).</p> <table border="1" data-bbox="587 443 1386 902"> <thead> <tr> <th rowspan="3">Kualifikimi i stafit akademik të</th> <th colspan="6">Departamentit i Gjuhëve të Huaja</th> </tr> <tr> <th colspan="2">2020-2021</th> <th colspan="2">2021-2022</th> <th colspan="2">2022-2023</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>2</td> <td>4</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr/Phd</td> <td>20</td> <td>2</td> <td>19</td> <td>3</td> <td>14</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>Msc.</td> <td>2</td> <td>27</td> <td>2</td> <td>23</td> <td>4</td> <td>19</td> </tr> <tr> <td><b>Gjithsej</b></td> <td><b>24</b></td> <td><b>31</b></td> <td><b>23</b></td> <td><b>29</b></td> <td><b>22</b></td> <td><b>25</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>Departamenti është i organizuar në katër grupe mësimore me karakter kërkimor-shkencor, përkatësisht: grupin e shkencave gjuhësore, grupin e shkencave letrare, grupin e shkencave të edukimit dhe atë të historisë dhe kulturës. Departamenti ka stafin e duhur të kualifikuar dhe në përputhje me fushat akademike dhe kërkimore që përfshin programi i aftë për realizimin e programit. Departamenti angazhon disa lektorë të ftuar.</p> <p>Evidencë. 15-Rregullore, Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2019</p> <p>Evidencë. 71- Grupet mësimore në Departament</p>	Kualifikimi i stafit akademik të	Departamentit i Gjuhëve të Huaja						2020-2021		2021-2022		2022-2023		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr	-	1	-	1	-	1	Prof. Asoc.	2	1	2	2	4	-	Dr/Phd	20	2	19	3	14	5	Msc.	2	27	2	23	4	19	<b>Gjithsej</b>	<b>24</b>	<b>31</b>	<b>23</b>	<b>29</b>	<b>22</b>	<b>25</b>
Kualifikimi i stafit akademik të	Departamentit i Gjuhëve të Huaja																																																						
	2020-2021		2021-2022		2022-2023																																																		
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																	
Prof. Dr	-	1	-	1	-	1																																																	
Prof. Asoc.	2	1	2	2	4	-																																																	
Dr/Phd	20	2	19	3	14	5																																																	
Msc.	2	27	2	23	4	19																																																	
<b>Gjithsej</b>	<b>24</b>	<b>31</b>	<b>23</b>	<b>29</b>	<b>22</b>	<b>25</b>																																																	
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Nga shtyrimi i dokumentacionit të DVV dhe bisedave me personelin akademik GVJ konstaton se DGjH, përgjegjës për programin e studimit Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, angazhon personelin e brendshëm akademik në realizimin e praktikave mësimore.</p> <p>Evidencë. 15-Rregullore, Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2019</p> <p>Evidencë. 130 -Rregullore e praktikës, 2019</p> <p>Evidencë.131 -Ndarja e praktikës në Departament</p>																																																						
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo</p>	<p>Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm dhe takimeve me stafin GVJ konstaton se kordinatori i këtij programi është drejtuesi i njësisë bazë. Detyrat e tij janë të përcaktuara në Rregulloren e</p>																																																						

<p>program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>NJBSC. Përgjegjësja ka ndjekur ecurinë e zhvillimit të programit dhe të praktikave profesionale, e evidentuar në dokumentacionin e dorëzuar në dosjen e VV.</p> <p>Evidencë. 20-Rregullorja për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, Neni 10</p> <p>Evidencë. 137- RVB MP Mesues i Gjuhës Angleze</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>FE dhe DGjH, si përgjegjës për programin e studimit MP "Mësues i Gjuhës Angleze" përmbushin të gjitha detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Departamenti ka stafin e duhur të kualifikuar dhe në përputhje me fushat akademike dhe kërkimore që përfshin programi.</i></p> <p><i>DGJH angazhon personelin e brendshëm akademik në realizimin e praktikave profesionale .Drejtuesi i njësisë bazë është përgjegjës për zbatimin e programit të ciklit të dytë, si koordinator i tij, dhe ndjek nga afër ecurinë e këtij programi. Për sa më sipër GVJ konstaton se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi II.3**

**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Referuar Dosjes së Vetevlerësimit, GVJ konstaton se FE dhe DGjH kanë informacionet dhe dokumentacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e funksionimin e programit të studimit. Këto janë si në Rregulloren e UAMD-së, Rregulloren e Fakultetit të Edukimit, Rregulloren e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, Rregulloren e programit të studimit, si dhe vendimet për kriteret hyrëse, planin mësimor dhe programet lëndore, procedurat e diplomimit. Këto dokumenta janë të njohura nga njësia bazë.</p>




	<p>Evidencë. 5-Rregullore UAMD</p> <p>Evidencë. 15-Rregullore, Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”</p> <p>Evidencë. 37-Dosja e Plotë e Masterit Profesional "Mësues i Gjuhës Angleze" pas Riorganizimit</p> <p>Evidencë. 129 -Kurrikula e MP Mesues i gjuhës angleze, 2022-2024</p> <p>Evidencë..130-Rregullore e Praktikës, 2019</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze” përmban planin mësimor ku jepen informacionet e duhura për ndarjen e lëndëve sipas kategorive përkatëse, veprimtaritë formuese, semestrat kurdo zhvillohet lënda. Plani mësimor është i ndarë në katër semestra me 30 kredite secila. Në tre semestrat e para zhvillohen 18 lëndë, secila me 5 kredite, 30 orë leksione dhe 15 orë seminare. Në secilin semestër zhvillohen 270 orë në auditor dhe 480 orë përgatitje e studentëve. Në semestrin e katërt 12 kredite i janë caktuar praktikës, për të cilën zhvillohen 75 orë në auditor dhe sipas rregullores së praktikës dhe takimeve me pedagogët e departamentit, 25 orë zhvillohen në shkollat e rrethit. 18 kredite janë për përgatitjen e punimit të diplomës.</p> <p><i>GVJ mendon se duhet të rishikohet raporti i orëve në auditor dhe atyre që zhvillohen në shkollat, gjatë kryerjes së praktikës profesionale.</i></p> <p><i>Gjithshtu GVJ mendon se raporti leksion seminar duhet të ndryshojë në disa lëndë, të cilat të kenë më shumë orë seminaresh për të vënë theksin dhe zhvilluar aftësitë gjuhësore të studentëve.</i></p> <p>Lëndë si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Standard i shkrimit në gjuhën Angleze;</li> <li>- Zhanri letrar në mësimdhënien e gjuhës angleze;</li> <li>- Mësimdhënia nëpërmjet kontekstit historik (ANG);</li> <li>- Gramatikë e Avancuar e gjuhës Angleze;</li> </ul> <p>GVJ e ngriti këtë problem gjatë vizitës në institucion dhe takimin me stafin akademik të programit. Ata shprehën se kjo ndarje është thjesht për lehtësi, se në praktikë mësim zhvillohet duke integruar leksionet me seminarët.</p>






	<p>Evidencë . 129 -Kurrikula e MP Mesues i gjuhës angleze, 2022-2024</p> <p>Evidencë .124-Syllabuset e Lëndëve</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ vlerëson se programi i studimit Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze” specifikon kriteret përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Këto janë përcaktuar në rregulloren së UAMD, të FE, të DGjH dhe të programit të studimit. Gjatë takimit me stafin GVJ u informua se studentët kanë mundësi të informohen rregullisht mbi këto kritere edhe përmes faqes zyrtare të UAMD-së si dhe nga njoftimet e ndryshme që afishohen në mjediset e universitetit.</p> <p>Evidencë.9-Rregullore FE.pdf ;</p> <p>Evidencë 15-Rregullore, Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2019</p> <p>Evidencë 62-Kriteret e Pranimit të Propozuara nga Njësia Bazë , 2022-2023</p> <p>Evidencë.63-Kriteret e Transferimit të Studentëve në Programin MP “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2021-2022</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze” përmban programet lëndore (syllabuset e detajuara). GVJ konstaton se ato janë hartuar në përputhje me formatet e miratuara. Programi i lëndës jep informacion mbi pedagogun që do të zhvillojë modulën/lëndën dhe vitin akademik dhe semestrin akademik kur mund të ndiqet lënda, tipologjinë e modulit/lëndës, kreditet ECTS, objektivat e modulit/lëndës; konceptet themelore të lëndës, kalendarin javor me temat përkatëse; detyrimet e studentit; formatet e kontrollit të dijeve dhe vlerësimin e tyre, si dhe literaturën përkatëse. Syllabuset hartohen nga pedagogët përgjegjës në nisje të semestrit dhe miratohen nga drejtuesi i njësisë bazë, i cili merr miratimin e grupit mësues dhe kërkimor-shkencor për syllabuset të cilat mbulohen nga ky grup.</p> <p>Evidencë.37-Dosja e Plotë e Masterit Profesional _Mësues i Gjuhës Angleze_ pas Riorganizimit, 2018-2019</p> <p>Evidencë.124-Syllabuset e Lëndëve</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe</p>	<p>Referuar dokumentacionit paraqitur në DVV, GVJ konstaton se Departamenti i Gjuhëve të Huaja në vijimësi përmirëson si kurrikulën ashtu edhe programet lëndore me qëllim përshtatjet</p>






<p>përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>me ndryshimet ligjore dhe përmirësimin e përmbajtjes, literaturës dhe metodologjisë. Në çdo vit akademik miratohen e firmosen syllabuset e lëndëve nga Përgjegjësi i Departamentit dhe dosja arkivohet. Gjithashtu pasqyrohet në faqen online të UAMD-së plani mësimor me informacionin e nevojshëm për studentët. Në javën e parë të fillimit të semestrit, studentëve i paraqitet i detajuar syllabus-i nga lektori i lëndës lidhur me përmbajtjen e lëndës, mënyrën e organizimit dhe vlerësimit.</p> <p>Evidencë.37-Dosja e Plotë e Masterit Profesional _Mësues i Gjuhës Angleze_ pas Riorganizimit, 2018-2019</p> <p>Evidencë.40-Ndryshimet në Planin Mësimor pas Riorganizimit</p> <p>Evidencë.128-Argumentimi i Riorganizimit të Kurrikulës MP _Mësimdhënie e Gjuhës Angleze</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>PS i MP është hartuar në mënyrë të detajuar dhe është informues. FE dhe DGjH disponojnë informacionet dhe dokumentacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e funksionimin e programit të studimit. Ato përcaktojnë strukturën akademike që e ofron PS dhe strukturat e tjera mbështetëse, objektivat e programit dhe kompetencat e formimit, kriteret hyrëse, planin mësimor dhe programet lëndore, procedurat e diplomimit.</i></p> <p><i>Syllabuset e lëndëve përmbajnë gjithë informacionin e detajuar për zhvillimin e lëndës. GVJ vuri re se të gjitha lëndët zhvillohen me 30 orë leksione dhe 15 orë seminare. GVJ mendon se raporti leksion seminar duhet të ndryshojë në disa lëndë, ku theksi duhet të vihet në zhvillimin gjuhësor të studentëve. Konstatohet se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi II.4**


**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrin Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**




<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se lëndët e përfshira në këtë PS Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze” pajisin studentët me njohuri të thelluara në fushën e edukimit, i formojnë ata nga ana psikopedagogjike, ju japin njohuri të thella dhe aftësi në mësimdhënien e gjuhës angleze, i pajisin me aftësi të punës kërkimore në arsim. Organizimi i praktikës profesionale dhe ndjekja e saj nga pedagogë të brendshëm mundëson aftësimin e studentëve praktik të studentëve për mësimdhënie.</p> <p>Evidencë 37-Dosja e Plotë e Masterit Profesional "Mësues i Gjuhës Angleze" pas Riorganizimit</p> <p>Evidencë 44-Studimi i tregut të punës pas Diplomimit të Studentëve, Shtator 2020</p> <p>Evidencë 49-Udhëheqje e Temave të Diplomave, MP “Mësues i Gjuhës Angleze” 2021-2022</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>GVJ konstaton se lëndët e programit të studimit, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si dhe vlerësimi në kredite mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit që synon të përgatisë specialistë me formimin profesional të fushës së metodikës së gjuhës angleze si gjuhë e huaj.</p> <p>Komponentët mësimorë të mësimin në auditor (leksione, seminare) nxisin aftësimin praktik dhe përdorimin e gjuhës angleze në specifikat e fushave të përfshira në program. Këto reflektohen në syllabuset lëndore përkatëse. Kontrolli i vazhueshëm, provimi i ndërmjetëm (400 pikë), provimi përfundimtar (500 pikë) dhe detyrat e kursit (100 pikë) sigurojnë një vazhdimësi si në përgatitjen e studentëve ashtu edhe në vlerësimin më objektiv të tyre. Vlerësimi i studentëve bëhet vetëm me shkrim.</p> <p><i>GVJ sugjeron se duhet të bëhet një kombinimi i vlerësimit me gojë dhe me shkrim, për vetë specifikën e programit</i></p> <p>Evidencë 37-Dosja e Plotë e Masterit Profesional "Mësues i Gjuhës Angleze" pas Riorganizimit</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të</p>	<p>GVJ konstaton se struktura e programit, lëndët dhe raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e tij, formimit të mësuesve të aftë, me kompetenca dhe formim të thelluar profesional. Programi i pajis studentët me njohuri dhe aftësi të thelluara në gjuhën e huaj, në shkencat e edukimit, në edukimin ndërkulturor, në përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie dhe në aftësimin e</p>




<p>ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>tyre për të bërë kërkime në veprim, në klasën e gjuhës së huaj. Vlerësimi i praktikës profesionale me 12 kredite mundëson thellimin e njohurive teorike në terren dhe krijimin e kompetencave profesionale të studentëve.</p> <p>Raporti teorik praktik është në përputhje me profilin e programit. Kjo reflektohet nga realizimi i praktikës profesionale (12 kredite)dhe në zhvillimin e secilës lëndë. Programi reflekton ngjashmëri të konsiderueshme me programe simotra në vend. Mobilitetet e studentëve dhe pedagogëve reflektojnë përputhjen e kësaj strukture me programe të ngjashme.</p> <p>Evidencë. 15-Rregullore, Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2019</p> <p>Evidencë .78-Mobilitete të Stafit Akademik FE</p> <p>Evidencë.124-Syllabuset e Lëndëve</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Mësues i Gjuhës Angleze” është përgatitur në përputhje me legjislacionin në fuqi. GVJ konstaton se përcaktimi i Krediteve për secilen lëndë dhe raporti i drejtë i krediteve për kategorite e lëndëve, mundëson arritjen e objektivave të programit dhe lehtëson procedurat e transferimit, mobilitetet e studentëve. Kjo edhe pse programi është i përafërt me programe që përgatisin mësues të të njëjtit profil.</p> <p>Evidencë.79-Analiza Vjetore e Njësisë Bazë në lidhje me MP “Mësues i Gjuhës Angleze”2021-2022</p> <p>Evidencë.44-Studimi i tregut të punës pas Diplomimit të Studentëve, Shtator 2020</p> <p>Evidencë.15-Rregullore, Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2019</p> <p>Evidencë.63-Kriteret e Transferimit të Studentëve në Programin MP “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2021-2022</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë</p>	<p>Nga biseda gjatë vizitës në institucion me Përgjegjësen e Departamentit dhe me pedagogët që mbulojnë lëndë në këtë program studimi GVJ u informua se çdo fillim viti bëhet përditësimi i syllabuseve me qëllim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- rishikimet dhe përditësimet në kurrikul;</li> <li>- përditësimin e përmbajtjes dhe literaturës dhe të lëndës;</li> </ul>




<p>dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Kjo literaturë përditësohet në mënyrë të vazhdueshme duke iu referuar botimeve të 5 viteve të fundit. Literatura ofrohet në gjuhën angleze dhe gjendet në bibliotekat online. FE ka siguruar bashkëpunim me disa biblioteka serioze on line.</p> <p><i>GVJ sugjeron se biblioteka e Fakultetit duhet të ketë më shumë fonde fizike, sepse numri i librave fizik në dispozicion të studentëve për lëndët e këtij programi është minimal.</i></p> <p>Evidencë .124-Syllabuset e Lëndëve</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Mësues i Gjuhës Angleze” pajis studentët me njohuri të thelluara në fushën e mësuesisë dhe më specifikisht të mësuesit të gjuhës angleze dhe me aftësi praktike për mësimdhënie. Struktura e programit, raporti teori praktike, përfshirja e studentëve në kryerjen e detyrave të kursit, praktika profesionale dhe shkrimi i punimit përfundimtar garantojnë përfitim të kompetencave të synuara.</p> <p>Evidencë . 37-Dosja e Plotë e Masterit Profesional "Mësues i Gjuhës Angleze" pas Riorganizimit</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>GVJ konstaton se përmbajtja e programit mundëson punësimin e studentëve të diplomuar si mësues në shkolla private dhe/ose publike. Gjithashtu, institucioni nëpërmjet Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, orienton dhe këshillon studentët në lidhje me punësimin. Studimet e kryera tregojnë se studentët e diplomuar nga ky program janë të aftë të plotësojnë kërkesat e tregut.</p> <p>Evidencë .44-Studimi i tregut të punës pas Diplomimit të Studentëve, Shtator 2020</p> <p>Evidencë .66-Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD-ës;</p> <p>Evidencë .29-Rregulloret e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Përmbajtja e PS Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze” i pajis studentët me njohuri të thelluara, aftësi dhe kompetenca në fushën e edukimit dhe mësimdhënies së gjuhës së huaj.</i></p> <p><i>Struktura e programit, raporti teori praktike, përditësimi i syllabuseve çdo vit, vlerësimi i vazhduar dhe objektiv garantojnë përfitim të kompetencave të synuara dhe mundësinë që studentët të transferojnë studimet e tyre në programe të ngjashme. GVJ konstaton se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi II.5

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	<p>DGjH mbështetet në “Planin e Zhvillimit Strategjik” të UAMD. Në këtë kuadër DGjH ka siguruar bashkëpunim me DAR, me Alumni dhe gjatë këtyre takimeve departamenti konsultohet dhe merr parasysh propozimet e tyre me qëllim njohjen e nevojave të tregut të punës.</p> <p>Evidencë .4-Planii zhvillimit Strategjik UAMD, 2020-2025</p> <p>Evidencë. 29-Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës</p> <p>Evidencë .30-Qendra e Karrieres</p> <p>Evidencë .31-Takime Alumni.</p> <p>Evidencë .44-Studimi i tregut të punës pas Diplomimit të Studentëve, Shtator 2020</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	<p>Sipas DVV DGjH mban kontakte dhe konsultohet me studentët e diplomuar në këtë program dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit me qëllim përditësimin e programit të studimit Master Profesional. Sipas Statutit dhe Rregullores të Sistemit të Brendshëm të Cilësisë studentët janë të përfaqësuar në çdo organ kolegjal të institucionit. DGjH mundëson pjesëmarrjen dhe angazhimin e studentëve në diskutime të hapura për të përmirësuar aspektet praktike të lidhura me formimin profesional të studentëve nga ky program.</p> <p>Evidencë.20- Rregullorja për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë</p> <p>Evidencë .21-Rezultatet nga Anketimi i Studentëve</p>
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson,	Referuar DVV GVJ konstaton se DGjH analizon çdo vit nevojat e tregut dhe harton planin strategjik të programit në përputhje me






<p>përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>planin strategjik të institucionit. Përmirësimet që prekin programin lidhen me përshtatjen e programeve lëndore, trajnime jashtë kurrikulare, trajnime të personelit akademik në fusha specifike, zhvillimin e projekteve të përbashkëta apo bashkëpunimeve, organizimin e konferencave me departamente të njëjta etj</p> <p>Evidencë.14-Strategjia e Departamentit të Gjuheve të Huaja, 2020-2025</p> <p>Evidencë.26-Plani i Zhvillimit Strategjik të Programit MP “Mësues i Gjuhës Angleze”</p> <p>Evidencë.92-Raport mbi Veprimtarinë Mësimore-Shkencore të Departamentit, 2021--2022</p> <p>Evidencë.93-Raporti i Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore të Departamentit, 2021-2022</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se me qëllim përmirësimin e programit të studimit Master Profesional DGjH mban kontakte dhe konsultohet me studentët e diplomuar në këtë program dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</i></p> <p><i>Pjesëmarrja dhe angazhimi i studentëve dhe Alumni në diskutime të hapura për të përmirësuar aspektet praktike të lidhura me formimin profesional të studentëve nga ky program informacioni që vjen nga bashkëpunimi me palët e treta dhe nga analizat për nevojat e tregut shërbejnë për përshtatjen dhe përditësimin e programit. Ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p><b>Standardi II.6</b></p>	
<p><b>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në</p>	<p>Programi Master Profesional në Mësues i Gjuhës Angleze është në përputhje me strategjinë e institucionit si dhe atë të njësisë bazë. Ai synon formimin e kompetencave dhe kapaciteteve analitike të nevojshme tek studentët për trajtimin e problematikave teorike dhe praktike në shkolla, të cilat studenti</p>






<p>përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>duhet t'i zotërojë në përfundim të ciklit të dytë të studimit. Objektivat kryesore të UAMD janë të zërthyer në këtë program në objektivat dhe rezultatet e të nxënësve, në komponentët formues të tij. Studentët pajisen me njohuri të thella të teorisë së edukimit, zhvillojnë aftësitë krijuese, ndërvepruese, të mendimit kritik dhe pavarësisë; aftësohen si të zgjidhin problemet në mjedisin e shkollës, si dhe zhvillojnë aftësitë e tyre në studime kulturore, gjuhësore dhe letrare mbi gjuhën angleze dhe shqipe si dhe cilësinë e mësimdhënies.</p> <p>Evidencë.4-Plani i Zhvillimit Strategjik UAMD, 2020-2025</p> <p>Evidencë.92-Raport mbi Veprimtarinë Mësimore-Shkencore të Departamentit, 2021—2022</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar GVJ konstaton se UAMD, Fakulteti i Edukimit dhe Departamenti i Gjuhëve të Huaja, në përputhje me legjislacionin në fuqi bashkërendojnë dhe menaxhojnë veprimtaritë e mësimdhënies dhe kërkimore të personelit akademik duke respektuar lirinë akademike të tyre. Kjo shprehet më së miri në rregulloret e miratuara për këtë qëllim. Kjo nxitje dhe mbështetje e institucionit për stafin akademik u theksua edhe gjatë vizitës së GVJ në institucion.</p> <p>Evidencë.53-Vendim Senati për Miratimin e Ngarkesës Mësimore Realizuar nga Personeli Akademik me Kohë të Plotë dhe të Pjesshme.</p> <p>Evidencë.90-Baza e Kërkimit Shkencor në Njësinë Bazë</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>GVJ konstaton se programi motivon studentët që të marrin pjesë në projekte dhe aktivitete ku ata mund të trajtojnë çdo problematike që lidhet me mësimdhënien e gjuhës së huaj, si nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca dhe punimet të temave të diplomës. Temat e punimeve të diplomës tregojnë se trajtohen çështje me rëndësi për mësimdhënien e gjuhës së huaj duke filluar nga mësimi i aftësive gjuhësore në mënyrë aktive, menaxhimi i klasës, mësimi me në qendër studentin, përdorimi i teknologjisë, edukimi ndërkulturor etj.</p> <p><i>GVJ konstaton se numuri i studentëve të përfshirë në mobilitet është i ulët, dhe se departamenti duhet nxisë më shumë studentë për të përfituar nga programi Erasmus+.</i></p>




	Evidencë.49-Udhëheqje e Temave të Diplomave, MP “Mësues i Gjuhës Angleze” 2021-2022			
	Evidencë.91-Konferencat e Organizuara nga Njësia Bazë			
<b>Kriteri 4.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Referuar dokumentave të dorëzuar GVJ konstaton se Institucioni mbështet veprimtarinë studimore e kërkimore të njësisë bazë. Gjatë vizitës në institucion dhe takimeve me pedagogët ata theksuan se e ndjejnë mbështetjen e institucionit për zhvillimin e tyre profesional dhe për përfshirjen në veprimtari kërkimore. Secilit i mundësohet financiarisht të realizojë një botim në revista të njohura ndërkombëtare, përveç mbështetjes për kërkim, rezultatet e të cilëve paraqiten në konferencat që organizon departamenti, FE, ose UAMD.  Evidencë.70-Vendim Nr.384 Miratim i Rregullores së Menaxhimit të Aktiviteteve Shkencore dhe Akademike në UAMD.  Evidencë.4-Plani i Zhvillimit Strategjik UAMD, 2020-2025			
<b>Konkluzione</b>	<i>PS i MP Mësues i Gjuhës Angleze ka përcaktuar qartë objektivat e studimit dhe kërkimit shkencor, të cilat janë në përputhje me objektivat dhe përparësitë e UAMD. Institucioni mbështet financiarisht veprimtarinë mësimore dhe kërkimore të programit.  Kjo realizohet nëpërmjet një drejtimi të mirëorganizuar të mbështetur në rregulloret e miratuara, duke mbështetur stafin dhe studentët. Në takimin e organizuar gjatë vizitës në institucion. GVJ, u vu në dijeni se personeli akademik ndjen mbështetjen e institucionit për zhvillimin e tyre profesional dhe për përfshirjen në veprimtari kërkimore dhe se gëzon liri akademike. Nisur sa më lart GVJ konstaton se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi II.7

**Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

28




<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>GVJ konstaton se DGjH ka ngritur dhe mbështet grupet lëndore në zhvillimin e veprimtarisë së tyre dhe siguron bashkëpunim me strukturat e tjera për realizimin e objektivave për kërkim shkencor. Kjo realizohet në përputhje me rregulloret e institucionit. Gjatë vizitës GVJ u informua se disa pedagogë të departamentit janë pjesë e projekteve të FE dhe të Institucionit dhe janë motivuar dhe mbështetur nga departamenti.</p> <p>Evidencë.71-Memoja mbi ndarjen e grupeve lëndore në departament;</p> <p>Evidencë.88-Rregullore e Organizimit të Konferencave dhe Veprimtarive Shkencore UAMD</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>DGjH për realizimin e objektivave të punës kërkimore bazohet në Planin strategjik të kërkimit të UAMD (2020-2025) dhe Rregulloren e programit të studimit Master Profesional në Departamentit të Gjuhëve të Huaja dhe mbështet stafin për realizimin e objektivave për kërkim shkencor.</p> <p>Evidencë.4-Plani i Zhvillimit Strategjik UAMD, 2020-2025</p> <p>Evidencë.90-Baza e Kërkimit Shkencor në Njësinë Bazë</p> <p>Evidencë.12-Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, 2019</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Mbështetur në DVV GVJ konstaton se DGjH ka organizuar në mënyrë të vazhdueshme konferenca shkencore në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit duke u mundësuar stafit akademik dhe studentëve të japin kontributin e tyre në realizimin e objektivave në fushën e mësimin dhe kërkimit.</p> <p>Evidencë.88- Rregullore e Organizimit të Konferencave dhe Veprimtarive Shkencore UAMD</p> <p>Evidencë.91-Konferencat e Organizuara nga Njësia Bazë</p> <p>Evidencë.92-Raporti mbi Veprimtarinë Mësimore-Shkencore të Departamentit, 2021-2022</p> <p>Evidencë.93-Raporti i Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore të Departamentit, 2021-2022</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit formon profesionistë konkurrues</p>	<p>GVJ konstaton se përmbajtja e PS Master Profesional në “Mësues i Gjuhës Angleze” është plotësisht në funksion të qëllimit për të cilin është hartuar. Lëndët e formimit të përgjithshëm dhe</p>

<p>për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>karakterizues, përmbajtja e syllabuseve të lëndëve, angazhimi i studentëve në punë të pavarur kërkimore, dhe praktika profesionale i pajisin studentët me aftësi dhe kompetenca profesionale, me aftësi praktike dhe kërkimore gjë që i bën ata konkurrues për tregun e brendshëm dhe ndërkombëtar të punës.</p> <p>Evidencë.124-Syllabuset e Lëndëve</p> <p>Evidencë.44-Studimi i tregut të punës pas Diplomimit të Studentëve, Shtator 2020</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>GVJ u informua në takimin në institucion që DGjH vazhdimisht ka përditësuar syllabuset dhe përditësuar programin që të përfshijë dhënjen e kompetencave të nevojshme për marrjen e licencës nga mësuesit. Këtë e ka bërë bazuar në njohjen e nevojave për marrjen e licencës nga mësuesit. Informacioni i duhur sigurohet nga pjesëmarrjet në panairët e karrierës, rrjetet profesioniste apo nga ndërveprimi praktik me palët e treta.</p> <p>Evidencë.30-Qendra e Karrieres</p> <p>Evidencë.31-Takime Alumni</p> <p>Evidencë.44-Studimi i tregut të punës pas Diplomimit të Studentëve, Shtator 2020</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>GVJ vlerëson se PS Master Profesional në “Mësues i Gjuhës Angleze” është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi për programet Master që përgatisin mësues. Në hartimin e këtij programi studimi janë marrë në konsideratë objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë.</p> <p>Evidencë.129-Kurrikula Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2022-2024</p> <p>Evidencë.43-Marrëveshjet e Bashkëpunimit UAMD me Programin Erasmus</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>DGjH mbështet grupet lëndore në zhvillimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore dhe siguron bashkëpunim me strukturat e tjera për realizimin e objektivave për kërkim shkencor duke përfshirë edhe studentët në këtë process.</i></p> <p><i>Ndërtimi i programit, përmbajtja e syllabuseve dhe organizimi mësimi, i pajis studentët me aftësi dhe kompetenca profesionale, gjë që i bën ata konkurrues për tregun e brendshëm dhe</i></p>




	<i>ndërkombëtar të punë dhe i përgatit studentët e PS për marrjen e licencës së profesionit mësues i gjuhës së huaj. Ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksione, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar GVJ konstaton se format e mësimdhënies dhe nxënies janë në përputhje me ë Rregulloren e UAMD. Orët në auditor ndahen në leksione dhe seminare. Detyrat e kursit të punuara dhe prezantuar në formë eseje ose projekte individuale ose në grup kanë një rol të veçantë në vlerësimin përfundimtar. Organizimi dhe zhvillimi i Praktikës Profesionale u mundëson studentëve të praktikojnë njohuritë teorike të përvetësuara në ambiente shjkollore.  Evidencë.5-Rregullore UAMD, Neni 40,48 dhe Neni 60 Evidencë.15-Rregullore, Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”  Evidencë.130-Rregullore e Praktikës, 2019
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke	GVJ konstaton se personeli akademik i përgjigjet nevojave të studentëve duke mbështetur interesat e tyre. Gjatë takimit në institucion pedagogët theksuan se përdorin metodat e mësimdhënies me në qendër studentin. Kështu studentëve ju



<p>ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>jepet mundësia të përgatiten dhe prezantojnë detyrat ose projekte në mënyrë individuale apo në grup.</p> <p>Gjithashtu zgjedhja e temës së diplomës mbështetet në propozimet e studentëve dhe kryhet në bashkëpunim me pedagogët. Në takimet e GVJ me studentët u theksua se mënyrat e organizimit të mësimit janë të larmishme dhe efektive. Studentët e programit Master vlerësuan pjesëmarrjen e tyre në veprimtari shkencore së bashku me pedagogët.</p> <p>Evidencë.82-Formulari i Vlerësimit të Programit të Studimit</p> <p>Evidencë.124-Syllabuset e Lëndëve Evidencë-49-Udhëheqje e Temave të Diplomave, MP “Mësues i Gjuhës Angleze” 2021-2022</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>UAMD mbështet personelin për përmirësimin e kompetencave të tyre pedagogjike si brenda institucionit ashtu edhe për trajnimin e personelit akademik në universitete partnere perëndimore. Organizimi i leksioneve të hapura është një formë e ndarjes së përvojës së fituar nga mobiliteti jashtë si dhe nga puna në auditor. Në shërbim të përmisimit të kompetencave didaktike shërbejnë edhe mjetet audio vizuale në dispozicion të procesit mësimor.</p> <p><i>GVJ vë re se duhet të ketë më shumë mjete audio vizuale në sallat e mësimit. Vetëm dy laboratorë të cilët janë ngritur me donacione të huaja funksionojnë, por nuk janë të përdorshëm nga të gjithë studentët.</i></p> <p>Evidencë 2- Strategjia e Ndërkombëtarizimit të UAMD</p> <p>Evidencë 26- Plani i Zhvillimit Strategjik të Programit MP “Mësues i Gjuhës Angleze”</p> <p>Evidencë 43-Marrëveshjet e Bashkëpunimit UAMD me Programin Erasmus</p> <p>Evidencë 80-Lista e Leksioneve të Hapura 2021-2022</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies</p>	<p>Nga DVV vihet se fusha akademike dhe kërkimore e lektorëve me kohë të plotë dhe ata të ftuar, të angazhuar në mësimdhënien në programin MP “Mësues i Gjuhës Angleze” është në përputhje me lëndët që japin. Në takimin me studentët e programit Master GVJ mësoi se studentët ndjehen mirë që frekuentojnë këtë program për disa arsye: për njohuritë që kanë fituar, për përfshirjen e tyre në jetën e institucionit, për</p>




<p>interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>mbështetjen që kanë gjetur në institucion për probleme të ndryshme dhe për trajtimin me respekt nga stafi akademik. Organizimi i mësimit, diskutimet, detyrat dhe projektet që zhvillohen kanë rritur nivelin e njohurive dhe aftësive të tyre.</p> <p>Evidencë. 16-CV-të e Personelit Akademik</p> <p>Evidencë.28- Procedurë Rekrutimi</p> <p>Evidencë. 48-Numri i Personelit Akademik Efektiv dhe me Kontratë në Program, 2021-2022</p> <p>Evidencë.105-Rregullore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore;</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Bazuar në DVV GVJ konstaton se UAMD ka një rregullore të brendshme të vlerësimit të performancës së pedagogut. Strukturat drejtuese kanë zhvilluar mekanizma të vlerësimit të veprimtarise mësimdhënëse të personelit.</p> <p>Njësitë e vetvlerësimit luajnë rol në këtë drejtim. Gjithashtu të dhënat nga vlerësimi i performancës së çdo individi analizohen dhe drejtuesi i njësisë bazë i cili kontakton çdo anëtar për të diskutuar gjetjet dhe mundësitë për përmirësim të mëtejshëm. UAMD përfshin studentët në vlerësimin periodik të formave dhe metodave të mësimdhënies duke ju dhënë mundësi atyre të plotësojnë pyetësorë periodikë për vlerësimin e të gjithë aspekteve akademike dhe administrative të jetës studentore. Autoritet drejtuese dhe përgjegjësit e departamenteve pasi bëjnë verifikimet e shqetësimeve të ngritura marrin masa konkrete me qëllim përmirësimin e situatës duke nxjerrë edhe rekomandime për vitin e ardhshëm.</p> <p>Evidencë.8-Raporti Vjetor UAMD</p> <p>Evidencë. 21-Rezultatet nga Anketimi i Studentëve</p> <p>Evidencë. 79-Analiza Vjetore e Njësisë Bazë në lidhje me MP “Mësues i Gjuhës Angleze”2021-2022</p> <p>Evidencë. 82-Formulari i Vlerësimit të Programit të Studimit</p> <p>Evidencë.83-Formulari i Vlerësimit të Stafit Akademik nga Studentët</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV rezulton se UAMD ka organizuar njësi në nivel institucional për promovimin e përmisimit të cilësisë, veprimtaria e të cilëve mbështetet në rregullore të miratuara.</p>

<p>vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Mjete të vlerësimit janë formularët e vetëvlerësimit të stafit akademik dhe formularët e studentëve.</p> <p>DGjH mbështet risitë në mësimdhënjen e pedagogëve nëpërmjet organizimit të leksioneve të hapura, një praktikë kjo tashmë e përvitshme. DGjH veçon dhe promovon praktikat më frytdhënëse të lektorëve në auditor.</p> <p>Evidencë. 5-Rregullore UAMD, Neni 68</p> <p>Evidencë. 22-Politika dhe Strategjia e Sigurimit të Cilësisë së Brendshme, FE</p> <p>Evidencë. 23-Raporti i Vlerësimit të Cilësisë së Brendshme FE</p> <p>Evidencë. 79-Analiza Vjetore e Njësisë Bazë në lidhje me MP “Mësues i Gjuhës Angleze”2021-2022</p> <p>Evidencë. 80-Lista e Leksioneve të Hapura 2021-2022</p> <p>Evidencë. 83-Formulari i Vlerësimit të Stafit Akademik nga Studentët</p> <p>Evidencë. 94- Formulari i Vetëvlerësimit të Personelit Akademik</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>DGjH nëpërmjet organizimit të këtij programi dhe menaxhimit të tij siguron arritjen e rezultateve në procesin e të nxënit.</i></p> <p><i>UAMD mbështet personelin për përmirësimin e kompetencave të tyre pedagogjike si brenda institucionit ashtu edhe për trajnimin e personelit akademik në universitete partnere perëndimore.</i></p> <p><i>UAMD ka ngritur mekanizma për vlerësimin e brendshëm të cilësisë, mekanizma të cilët përfshijnë edhe studentët.</i></p> <p><i>DGjH analizon dhe vlerëson gjithë procesin mësimor duke nxjerrë edhe rekomandime për vitin e ardhshëm, për të përmirësuar metodat e mësimdhënies.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron se duhet të ketë më shumë mjete audiovizuale në sallat e mësimit. Vetëm dy laboratorë, donacione të huaja, funksionojnë, por nuk mund të jenë të përdorshëm nga të gjithë studentët.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi III.2**

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive janë të përcaktuara në rregulloren e UAMD, në Rregulloren e FE dhe në Rregulloren e programit të studimit MP “Mësues i Gjuhës Angleze”. Ato janë të përcaktuara në syllabuset e çdo lënde, ku shpjegohet mënyra e vlerësimit, kundrejt pikëve në përqindje.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në institucion diskutoi për mënyrën e vlerësimit që zhvillohet në Universitet. Studentët e shikojnë këtë mënyrë të efektshme, sepse janë të sqaruar për mënyrën dhe për trasparencën e vlerësimit të tyre. Ata vlerësojnë mënyrën e njoftimit në sistem dhe mundësisë që iu jepet për të diskutuar nëse mendojnë se vlerësimi nuk është objektiv.</p> <p>Evidencë. 5-Rregullore UAMD, Kreu III, Neni 68</p> <p>Evidencë. 9-Rregullore FE, 2019, Seksioni IX, Neni 46</p> <p>Evidencë. 15-Rregullore, Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2019</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në Rregulloren e UAMD përcaktohet qartë detyrimi për të informuar studentin në fillim të çdo moduli në lidhje me metodologjinë e testimit të dijeve, njohurive dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabusin e lëndëve nga titullari. Në takimin me stafin GVJ u informua se pedagogu i lëndës njih studentët me programin e lëndës, mënyrën e vlerësimit të njohurive dhe literaturën që do të përdoret në modulën përkatës dhe mënyra e vlerësimit. Ky informacion gjëndet në secilin syllabus, në faqen zyrtare të UAMD dhe në faqet e UAMD në rrjetet sociale. Evidencë. 124-Syllabuset e Lëndëve</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të</p>	<p>GVJ konstaton se format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve të studentit janë bazuar në rregulloren e UAMD-së, Rregulloren e FE, dhe Rregulloren e studimeve të programit MP. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem notash nga 1 në 10. Provimi i ndërmjetëm</p>



<p>ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>ka 40% dhe zhvillohet në javën e 7 ose 8 dhe provimi përfundimtar me 50%, në javën e 15. Detyrat e kursit ose projektet vlerësohen me 10%.</p> <p>Gjatë takimit me pedagogë të programit GVJ u informua se testimi është më shkrim, por ata përfshijnë pyetje formuese që vlerësojnë drejt dijet dhe aftësitë e studentëve. Ata ruajnë një raport të drejtë midis pyetjeve objektive dhe subjektive në teste. Vlerësimi i detyrave të kursit me 10 % të vlerësimit të përgjithshëm jep atyre mundësi të përdorin forma të ndryshme të organizimit të paraqitjes së detyrës së kursit që studentët të mund të demonstrojnë aftësinë e tyre në aftësitë komunikative. Edhe gjatë takimit me studentët at vunë në dukje që përfshirja e kësaj mënyre të vlerësimit u jep mundësinë atyre të shprehin aftësitë dhe njohuritë e tyre, dhe të mësojnë në mënyrë të vazhdueshme.</p> <p>Evidencë. 124-Syllabuset e Lëndëve</p> <p>Evidencë.15-Rregullore, Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2019</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në Rregulloren e UAMD-së, në Rregulloren e FE dhe në Rregulloren e programit të studimit MP, janë të përfshira në syllabuset e lëndëve dhe bëhen publike në hapësirat dedikuar rregulloreve të studimeve përkatëse. Studentët informohen nga pedagogu i lëndës për kriteret dhe mënyrat e vlerësimit në fillim të zhvillimit të lëndës. Kontrolli i njohurive bëhet në shkrim dhe në testet me shkrim përfshihen pyetje formuese që vlerësojnë drejt dijet dhe aftësitë e studentëve.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se studentët e shikojnë këtë mënyrë të efektshme, sepse janë të sqaruar për mënyrën e vlerësimit të tyre dhe për transparencën e vlerësimit. GVJ konstaton se ky kriter përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

**Standardi III.3**




**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi studentëve të këtij programi bazohet në rregulloret e UAMD, FE, PS te MP. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem notash nga 4 në 10. Provimi i ndërmjetëm zë 40% të vlerësimit të përgjithshëm dhe zhvillohet në javën e 7 ose 8 dhe provimi përfundimtar zë 50%, në javën e 15 dhe 16. Detyrat e kursit ose projektet vlerësohen me 10%. GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive në këtë mënyrë garanton një vlerësim të studentëve në mënyrë të drejtë, të vazhdueshme dhe transparente.</p> <p>Evidencë 5-Rregullore UAMD, Kreu III, Neni 68;</p> <p>Evidencë 9-Rregullore FE, 2019, Seksioni IV, Neni 46</p> <p>Evidencë 15-Rregullore, Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2019</p> <p>Evidencë 124-Syllabuset e Lëndëve</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Institucioni ka zbatuar projekte pilot të testimit elektronik me bazë kodifikimin e tezave të studentëve. Ai vë në zbatim sistemin elektronik të testimit dhe vlerësimit, nëpërmjet marrëveshjes së nënshkruar me Fondin Shqiptar Amerikan të Zhvillimit (AADF) dhe projektit Clean Score, i cili eliminon forma të ndryshme abuzimi dhe rrit transparencën. DGjH përdor dhe format e vlerësimit tradicional, vlerësim më shkrim, të cilat korrigjohen nga komisione të caktuara nga departamenti.</p> <p>Evidencë 107-Përdorimi i CLEANSCORE në Testime</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstaton se vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet duke u bazuar në rezultatet e vlerësimit të studentëve që realizohet me testim të ndërmjetëm 40% dhe 50% e vlerësimit në provimin përfundimtar, si dhe 10% të vlerësimit e zë detyra/projekti i kursit të cilin studentët e prezantojnë në javën e 14-të të procesit mësimor. Forma e kontrollit të dijes në UAMD është me provim me shkrim. Mënyra e vlerësimit është e pasqyruar në syllabus-in e çdo kursi në përputhje me përcaktimet e akteve rregullatorë të FE dhe UAMD.</p>






	<p><i>GVJ mendon se programi përgatit mësues të gjuhës së huaj dhe mund t'i kushtojë më shumë vend në vlerësim, vlerësimin të aftësive komunikative, jo vetëm 10 %, si parashikohet deri tani.</i></p> <p>Evidencë5-Rregullore UAMD, Neni 62, pika 3</p> <p>Evidencë9-Rregullore FE, 2019</p>
<p><b>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</b></p>	<p>Vlerësimi i njohurive behet sipas rregulloreve në fuqi të institucionit. GVJ, nga takimi me studentë e këtij programi, u informua se atyre ju jepet feedback në orët e seminareve dhe gjatë paraqitjes së projekteve me qëllim përmisimin e performancës. Detyrat me shkrim shoqërohen me komente, ndërsa në takimet me pedagogët atyre ju jepet feedback për përmisime në të ardhmen. Studentëve u lind e drejta e ankimit sipas rregullave të parashtruara e në rregulloren e FE dhe të PS.</p> <p>Evidencë. 9-Rregullore FE, 2019</p> <p>Evidencë.15-Rregullore, Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2019</p>
<p><b>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</b></p>	<p>Me qëllim shmangjen e kopjimit ndiqen rregullat e parcaktuara nga institucioni për organizimin dhe monitorizimin e provimeve. Një rëndësi të veçantë tregohet për hartimin e tezave të reja në çdo sezon provimi si dhe në disa variante.</p> <p>Për të shmangur plagjiaturën në shkrimin e temave të diplomave pedagogu udhëheqësi mban kontakte të vazhdueshme me studentin duke i kërkuar informacion të detajuar për literaturën e përdorur në secilën nga pjesët e punimit si dhe për paraqitjen e gjetjeve si dhe duke i udhëzuar në vazhdimësi. GVJ gjatë takimit me pedagogët u njoh me shtetësimin e tyre në lidhje me kontrollin e plagjiaturës, kontrolli që kryhet me aplikacione që gjenden personalisht nga pedagogët. Institucioni nuk ka programe të dedikuara për këtë problem.</p> <p>Evidencë. 9-Rregullore FE, 2019</p> <p>Evidencë..49-Udhëheqje e Temave të Diplomave, MP “Mësues i Gjuhës Angleze” 2021-2022</p>
<p><b>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen</b></p>	<p>GVJ u informua se tezat ndërtohen në mënyrë të tillë që të vlerësojnë njohuritë dhe aftësitë e studentëve me pyetje formuese, përfshijnë të gjithë informacionet e marra gjatë</p>




<p>në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>zhvillimit të lëndës dhe miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit. Vlerësimi i provimit të ndërmjetëm dhe detyrës së kursit bashkohen me vlerësimin e provimit përfundimtar, të cilat pasi konsultohen paraprakisht me studentët hidhen brenda 72 orëve në sistemin Pitagora. Vonesa në dhënien e rezultatit të vlerësimit ngarkon me përgjegjësi administrative komisionin e provimit.</p> <p>Evidencë. 106- Komunikim për përdorimin e Sistemit PITAGORA</p> <p>Evidencë 15-Rregullore, Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2019</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstaton, nga takimet me studentët, se ata jo vetëm i njohin mënyrat e vlerësimit por njihen me vlerësimin e vazhduar përpara se të hyjnë në provimin përfundimtar. Vlerësimi i vazhduar hidhet në sistemin e UAMD-së, së bashku me vlerësimin e provimit final bazuar në rregulloren e studimeve të FE.</p> <p>Studentët u shprehën se ata shikojnë personalisht fletën e provimit në prani të pedagogut, për të marrë sqarimet e duhura. Rezultati i tyre pasqyrohet në sistem jo më vonë se 72 orë nga dita e zhvillimit të provimit përfundimtar. GVJ, gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, konstatoi se procesverbalet e firmosura dhe provimet të mbyllura në një zarf dorëzohen në Sekretarinë mësimore sipas procedurës së përcaktuar dhe mbahen në ruajtje sipas afateve të përcaktuara në rregulloren përkatëse.</p> <p>Evidencë 69-Rregullorja për Arshivimin e Dokumentacionit</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>UAM ka hartuar rregullore të vecanta për shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave të studentëve. Procedura ndjek disa hapa dhe dokumentohet. GVJ nuk konstatoi ndonjë praktikë të protokolluar, sepse nuk ka patur raste të ankesave për t’u trajtuar me komison ad-hoc.</p> <p>Evidencë. 5-Rregullore UAMD, Kreu III, Neni 71</p> <p>Evidencë. 15-Rregullore, Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2019</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>DGjH ndjek në vazhdimësi procesin e vlerësimit të dijeve, bazuar në rregulloret institucionale për gjithë procedurat për vlerësimin e dijeve, shpalljen e rezultateve si dhe shqyrtimin e</i></p>




	<p><i>ankimimeve apo nevojave për qartësime të studentëve. Këto rregullore njihen nga studentët.</i></p> <p><i>Vëmendje kushtohet për shmangjen e plagjiaturës, kopjimin në provime dhe detyra bëhet administrimi i provimeve sipas përcaktimit të rregulloreve, tregohet kujdes në hartimin e tezave dhe ndiqet me përgjegjësi puna e studentëve për shkrimin e tezës së diplomës.</i></p> <p><i>GVJ mendon se për karakteristikat e programit mund t'i lihet më shumë vend në vlerësim, vlerësimin të aftësive komunikative, jo vetëm 10 %, si parashikohet deri tani. GVJ konstaton se ky kriter përmbushet plotësisht.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar GVJ konstaton se programi i MP në “Mësues i Gjuhës Angleze” mundëson thellimin e njohurive gjuhësore dhe të formimit të përgjithshëm të fituara në Ciklin e parë të studimeve Bachelor si dhe zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve si mësues të ardhshëm. Lëndët e planit mësimor, praktika profesionale dhe punimi i temës së diplomës pajisin studentët më njohuri e aftësi të thella, me aftësi kërkimore në fushën e arsimit si dhe kompetenca si mësues.</p> <p>Evidencë. 37-Dosja e Plotë e Masterit Profesional "Mësues i Gjuhës Angleze" pas Riorganizimit</p> <p>Evidencë. 26- Plani i Zhvillimit Strategjik të Programit MP “Mësues i Gjuhës Angleze”</p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së	Programi i studimeve të ciklit të dytë MP i ka kushtuar rëndësi krahas formimit profesional të studentëve edhe zhvillimit të aftësive të veçanta si zhvillimin e aftësive kërkimore në arsim, aftësi të komunikimit dhe etikës si dhe të komunikimit

<p>informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>ndërkulturor. GVJ konstaton se përfshirja e lëndëve ndërdisiplinore integruese si Komunikim dhe etike, Pragmatika ndërkulturore, edukim ndërkulturor, metodat e kërkimit, formojnë një mësues të gjithanshëm dhe të aftë të punojë në grup në kontekste të ndryshme kulturore dhe sociale.</p> <p>Evidenca-39-Plani Mësimor për Programin MP Mësues i Gjuhës Angleze</p> <p>Evidenca-42-Suplementi i Diplomës MP “Mësues i Gjuhës Angleze”</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Syllabuset e kurseve përmbajnë qëllimin dhe rezultatet e të nxënit. Vlerësimi i nivelit të përfitimit të kompetencave të synuara kryhet në përfundim të lëndës. Ato janë objekt i analizës në department. GVJ u informua në takimet me stafin dhe studentët se në përfundim të lëndës bëhet përmbledhje e çështjeve më të rëndësishme të lëndës. Kjo është e parashikuar në syllabuse si seanca të veçanta për përsëritjen e lëndës.</p> <p>Evidencë 37-Dosja e Plotë e Masterit Profesional "Mësues i Gjuhës Angleze" pas Riorganizimi</p> <p>Evidencë 39-Plani Mësimor për Programin MP "Mësues i Gjuhës Angleze"</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e</p>	<p>Nga shyrtimi i dokumentacioni të dorëzuar GVJ konstaton se lëndët e programit janë të ndërtuara mbi bazë kompetencash. GVJ u informua se organizimi i mësimit, detyrat e kursit apo projektet sigurojnë pajisjen e studentëve me dije të qëndrueshme, mundësojnë zbatimin e njohurive teorike në raste simulimi në auditor dhe në praktikën profesionale. Detyrat e kursit shërbejnë si një bazë praktike shumë e rëndësishme për studentët për t’u familjarizuar me punën kërkimore edhe në përgatitjen e temës së diplomës. Personeli akademik krijon një klimë të përshtatshme për mbështetjen e studentëve dhe angazhimin e tyre në studime e në punën kërkimore, që shprehet dhe në organizimin e një konferencë shkencore studentore, me punime shkencore, në bashkëpunim me personelin akademik të DGjH.</p> <p>Evidencë 9-Rregullore FE, 2019, Seksioni IV, Neni 20 dhe Neni 54</p> <p>Evidencë.91-Konferencat e Organizuar nga Njësia Bazë</p>

mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Evidencë .130-Rregullore e Praktikës, 2019			
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	GVJ konstaon se DGjH ka realizuar orë të hapura mësimore në formën e leksioneve, të cilat ndiqen nga studentë dhe pedagogë të departamentit. Gjithashtu janë organizuar leksione të hapura jashtë strukturës së programit mësimor duke trajtuar për studentët informacione, të dhëna dhe problematika që lidhen me zhvillimet e reja shkencore në fushë n e më suesisë. Evidenca.80-Lista e Leksioneve të Hapura 2021-2022			
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Referuar dokumentacionit dhe takimeve në institucion GVJ konstaton se studentët janë në qendër të vëmendjes dhe politikave të UAMD. Ata mbështeten në shkrimin e punimeve të diplomave, nxiten dhe mbështeten për prezantimet e tyre në konferenca të organizuara nga Universitetet dhe Fakulteti si edhe në konferenca studentore. Studentët mbështeten vazhdimisht për të kryer një pjesë të studimeve në kuadër të programit Erasmus+ dhe në universitetet, me të cilat UAMD ka marrëveshje bashkëpunimi. Atyre u njihen kreditet e fituara dhe sipas marrëveshjeve përkatëse kanë edhe lehtësira financiare. Evidencë 5-Rregullore UAMD Evidencë 91-Konferencat e Organizuara nga Njësia Bazë			
<b>Konkluzione</b>	<i>DGjH është angazhuar për rritjen e cilësisë së programit, dhe i kushton kujdes një formimi tërësor të studentëve të mësuesië e me njohuri aftësi profesionale si dhe njohuri të vecanta për të formuar individë kërkues dhe të aftë të përshtaten me tregun e punës. Këtë e bën duke analizuar nivelin e përfutimit të kompetencave në fund të lëndëve, duke organizuar takime, leksione të hapura për integrimin e zhvillimeve të shkencës dhe teknologjisë në fushën e mësimdhënies së gjuhës angleze. Është një klimë e përshtatshme për mbështetjen e studentëve dhe angazhimin e tyre në studime e në punën kërkimore. Për sa më sipër GVJ konstaon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>



<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>GVJ konstaton se në rregulloret përkatëse janë paraqitur qartë procedurat për detyrimet përmbyllëse. Diplomimi bëhet me mbrojtjen e një teze diplome. Studentët njihen që në fillim të programit për formën e detyrimeve përmbyllëse. Studenti paraqet kërkesën pranë departamentit ku propozon temën e diplomës, fushën specifike të studimit dhe propozon pedagogun udhëheqës. Pas shqyrtimit nga departamenti përgatitet lista përfundimtare e studentëve e cila paraqet për miratim Dekanit të FE-së.</p> <p>Evidencë-9-Rregullore FE, 2019, Seksioni IV, Neni 52, 53 dhe Neni 56</p> <p>Evidencë.15-Rregullore, Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2019</p> <p>Evidencë.27-Rregullore Diplomimi FE</p> <p>Evidencë.135- Formulari i Kërkesës për Tezën e Diplomës dhe Vlerësimi</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>GVB konstaton se DGjH ndjek në mënyrë të organizuar dhe me përgjegjësi procedurat për përfundimet përmbyllëse. Studentët asistohen me udhëzime për përcaktimin e fushës kërkimore, si dhe më dokumentat respektive që të realizojnë punimin e diplomës dhe mbrojtjen e saj.</p> <p>Evidencë-15-Rregullore, Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2019</p> <p>Evidencë-134-Manual për Shkrimin e Diplomës, 2013</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të</p>	<p>Detyrimi përmbyllës në këtë PS MP në “Mësues i Gjuhës Angleze” është mbrojtja e temës së diplomës përpara komisionit të posaçëm, të përbërë nga pedagogë të departamentit. Anëtarët e komisionit propozohen nga departamenti përkatës dhe miratohen nga Dekani. Për vlerësimin e temave të diplomave, komisionet marrin në konsideratë: punimin e paraqitur në formë të shkruar;</p>

<p>rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>prezantimin e punimit para komisionit ; përgjigjet e studentit ndaj pyetjeve të komisionit . Vlerësimi bëhet me notë. Mbrojtja e temës së diplomës është publike.</p> <p>Evidencë-5-Rregullore, Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2019</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Referuar rregulloreve të miratuara dhe takimit me stafin GVJ vë re se udhëheqësi i punimit të diplomës orienton studentin në përcaktimin e pyetjeve kërkimore, udhëzon për literaturën si dhe ndihmon në përpunimin e të dhënave të punës kërkimore si dhe shkrimin cilësor të punimit në përputhje me udhëzuesit e miratuar.</p> <p>Evidencë-15-Rregullore, Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2019</p> <p>Evidencë-49-Udhëheqje e Temave të Diplomave, MP “Mësues i Gjuhës Angleze” 2021-2022</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Për realizimin e punimit, mbledhjen e të dhënave në ambientet e shkollave, studentëve u mundësohet hyrja në institucionet arsimore, në bazë të marrëveshjeve lidhur me DAR Durrës. Gjithashtu UAMD u mundëson studentëve përdorimin e bibliotekës e FE-së edhe të UAMD-së ku mund të navigojnë në internet dhe mund të shkarkojnë literaturë të mjaftueshme pa pagesë në ndihmë të realizimit të temës së studimit.</p> <p>Evidencë-15-Rregullore, Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2019.</p> <p>Evidencë-77-Marrëveshje Bashkëpunimi me DAR</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Vlerësimi i studentëve në mbrojtjen e diplomës bëhet sipas vendimit të senatit me sistemin e notave nga 4 në 10.</p> <p>Evidencë-135-Formulari i Kërkesës për Tezën e Diplomës dhe Vlerësimi.</p>

<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të programit të studimit MP “Mësues i Gjuhës Angleze” studenti pajiset me diplomën përkatëse. Elementet përbërëse, forma e diplomës dhe procedurat për regjistrimin përcaktohen nga ministria përgjegjëse për arsimin. Diplomat në UAMD për të gjitha ciklet e studimit lëshohen dy herë në vit sipas përcaktimeve të rektoratit. Në sekretarinë mësimore të njësisë kryesore, ruhet i gjithë dokumentacioni për çdo vit akademik. Studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, vetëm në rastet kur ai e kërkon këtë gjë. Pas mbrojtjes së temës së diplomës studenti pajiset me diplomën përkatëse, e cila i jepet atij së bashku me Suplementin e Diplomës ku jepen të detajuara arritjet e studentit në këtë program studimi.</p> <p>Evidencë-5-Rregullore UAMD, Kreu III, Neni 76.</p> <p>Evidencë-9-Rregullore FE, 2019, Seksioni IV, Neni 53</p> <p>Evidencë-41-Model Diplome, i Miratuar nga MASR, 2019.</p> <p>Evidencë-42-Suplementi i Diplomës MP “Mësues i Gjuhës Angleze</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe vizitën në sekretarinë mësimore vihet re se dokumentat e studentëve për periudhën e studimit nga hyrja në dalje mbahen, përpunohen dhe ruhen sipas rregullave përkatëse. Kjo gjë ndihmon për t'u shërbyer të interesuarve shpejt për transferim studimesh, hartimin e vërtetimeve të ndryshme, dhënie të listave të notave etj. Diplomat e Masterit Profesional regjistrohen në regjistrin shtetëror të diplomave dhe çertifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, që mbahet në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve.</p> <p>Evidencë-9-Rregullore FE, 2019, Seksioni IV, Neni 58, Neni 59 dhe Neni 60</p> <p>Evidence-69-Rregullorja për Arshivimin e Dokumentacionit</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UAMD, FE dhe DGjH kanë hartua dokumente dhe ndjekin një procedurë të posaçme për detyrimet përmblylëse, mbrojtjen e diplomës, të cilat bëhen publike dhe janë transparente. Në përfundim të programit të studimit MP “Mësues i Gjuhës Angleze” studenti pajiset me diplomën përkatëse së bashku me suplementin e saj. Elementet përbërëse, forma e diplomës dhe procedurat për regjistrimin përcaktohen nga ministria</i></p>

	<i>përgjegjëse për arsimin. GVJ kostaon se ky standard pë rmbushet [plotësisht].</i>			
<b>Shkalla e përbushjes sëstandardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimit dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	DGjH ka hartuar dokumente e duhura për zhvillimin dhe ndjekjen e praktikës profesionale. Departamenti siguron që praktika profesionale e studentëve të PS Master Profesional të zhvillohet në institucionet arsimore bazuar në një marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë Arsimore Rajonale Durrës. Studentit i jepet mundësi t’i zbatojë kompetencat e mësuar në auditor gjatë praktikës profesionale, e cila funksionon si një kurs i veçantë.  Evidencë-77-Marrëveshje Bashkëpunimi me DAR.  Evidencë-130-Rregullore e Praktikës, 2019
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfundimit më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	UAMD ka siguruar bashkëpunim me DAR Durrës për realizimin e praktikave profesionale për studentët e programit të studimit MP “Mësues i Gjuhës Angleze” me qëllim përfundimit sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale. Studentëve ju mundësohet mësimit dhe nxënies në mjedisin e shkollës duke punuar me një mentor të kualifikuar për të rritur efektivitetin e mësimit.  Evidencë-77-Marrëveshje Bashkëpunimi me DAR
<b>Kriteri 3.</b> Praktikave profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe	Referuar DVB dhe takimeve në institucion, GVJ konstaton se praktika profesionale ndiqet nga mësuesi mentor i shkollës dhe pedagogu i caktuar i departamentit.  Praktika profesionale zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të dytë të studimeve. Shuma e orëve të praktikës është 100 orë nga

dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	të cilat 25 orë zhvillohen pranë shkollave përkatëse dhe 75 orë në auditor me lektorin udhëheqës. Praktika vlerësohet me 12 kredite dhe vlerësohet me notë. Vlerësimi i studentit për lëndën e praktikës bazohet në shqyrtimin e dosjes së studentit praktikant, e cila përmban “Vlerësimin e praktikantit” nga mentori dhe portofolin e studentit.  <i>GVJ sugjeron që të rishikohet raporti i orëve të praktikës që zhvillohen në auditor me orët në institucionet arsimore, duke ju mundësuar studentëve më shumë ore praktike në shkolla.</i>  Evidencë-130-Rregullore e Praktikës, 2019								
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaon se ky standard përmbushet plotësisht sepse DGjH ka hartuar dokumente e duhura për zhvillimin dhe ndjekjen e praktikës profesionale mbështetur në marrëveshjet e arritura.</i>  <i>GVJ vlerëson se dokumentat mbështetëse që i jepen studentit janë shumë informuese dhe formuese. Organizimi dhe ndjekja e procesit konsiderohet si shumë të rëndësishme në formimin e mësuesve.</i>  <i>GVJ sugjeron që të rishikohet raporti i orëve të praktikës që zhvillohen në auditor me orët në institucionet arsimore.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				<b>X</b>
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			<b>X</b>						

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				<b>X</b>
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			<b>X</b>						

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

##### Standardi IV.1






**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin shoqërues të paraqitur në RVB dhe nga vizita në institucion GVJ konstaton që personeli akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit përgjatë tre viteve akademike është si më poshtë vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Për vitin akademik 2020-2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 13 pedagogë nga të cilët 11 PAE dhe 2 PAK (85% /015 %);</li> <li>2. Për vitin akademik 2021- 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 12 pedagogë nga të cilët 9 PAE dhe 3 PAK (75 % /25 %);</li> <li>3. Për vitin akademik 2022- 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 12 pedagogë nga të cilët 9 PAE dhe 3 PAK (75 % /25 %);</li> </ol> <table border="1" data-bbox="603 1055 1382 1458"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/grada</th> <th colspan="2">2020 - 2021</th> <th colspan="2">2021 - 2022</th> <th colspan="2">2022 - 2023</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE:</th> <th>PAK:</th> <th>PAE:</th> <th>PAK:</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof.As.Dr</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>3</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>8</td> <td>1</td> <td>7</td> <td>2</td> <td>5</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td><b>Në total</b></td> <td><b>11</b></td> <td><b>2</b></td> <td><b>9</b></td> <td><b>3</b></td> <td><b>9</b></td> <td><b>3</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>Ndarja e ngarkesës mësimore është bazuar në ekspertizën dhe përvojën që kanë pedagogët dhe është në përputhje me fushën e tyre kërkimore. Gjatë vizitës në institucion dhe bisedës me pedagogë GVJ u tinformua nga pedagogët e rinj se ata janë të mbështetur nga pedagogët me përvojë më të gjatë. Organizimi i leksioneve të hapura është një formë efektive për të përhapur përvojën më të mirë dhe për të shkëmbyer mendime me kolegë.</p> <p>Evidenca-54-Ngarkesa Mësimore e Personelit Akademik në të Gjitha Programet, 2021-2022.pdf</p>	Tituj/grada	2020 - 2021		2021 - 2022		2022 - 2023		PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:	Prof.Dr	1	1	1	1	1	1	Prof.As.Dr	2	-	1	-	3	-	Dr/PhD	8	1	7	2	5	2	Msc	-	-	-	-	-	-	<b>Në total</b>	<b>11</b>	<b>2</b>	<b>9</b>	<b>3</b>	<b>9</b>	<b>3</b>
Tituj/grada	2020 - 2021		2021 - 2022		2022 - 2023																																												
	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:																																											
Prof.Dr	1	1	1	1	1	1																																											
Prof.As.Dr	2	-	1	-	3	-																																											
Dr/PhD	8	1	7	2	5	2																																											
Msc	-	-	-	-	-	-																																											
<b>Në total</b>	<b>11</b>	<b>2</b>	<b>9</b>	<b>3</b>	<b>9</b>	<b>3</b>																																											




<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Numri dhe raporti i orëve mësimore të realizuara nga stafet akademike PAE / PAK në dy vitet e fundit akademike sipas të dhënave të tabelës 12 në (Evidencen 158 Tabelat permbledhese MP Mesues i Gjuhes Angleze) jepet në vijim dhe është në përputhje me kërkesat sipas legjislacionit në fuqi sipas të cilit PAE duhet të realizojnë të paktën 75% të ngarkesës mësimore në auditor.</p> <table border="1" data-bbox="600 564 1362 779"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Total orësh</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE/PAK (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>21-22</td> <td>1620</td> <td>1395</td> <td>225</td> <td>86% / 14 %</td> </tr> <tr> <td>22-23</td> <td>1080</td> <td>900</td> <td>180</td> <td>84% / 16%</td> </tr> </tbody> </table> <p>Evidencë- 158 -Tabelat permbledhese MP Mesues i Gjuhes Angleze</p>	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	21-22	1620	1395	225	86% / 14 %	22-23	1080	900	180	84% / 16%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)												
21-22	1620	1395	225	86% / 14 %												
22-23	1080	900	180	84% / 16%												
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni disponon dokumentacion të plotë për çdo anëtar të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe personelit ndihmës akademik dhe administrativ të angazhuar në këtë program studimi. Është nënshkruar një kontratë pune me afat të caktuar për kategorinë lektor me kohë të pjeshme dhe me afat të pacaktuar për kategoritë lektor dhe profesor, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Në rastet e kontratave me kohë të caktuar, rinovimi i tyre bëhet automatikisht bazuar në rekomandimin e Përgjegjësit të njësisë kryesore dhe Dekanit të Fakultetit të Edukimit në rastet kur performanca e personelit akademik është në nivelin e kërkuar. Të gjitha detyrimet financiare përfshi këtu dhe mbulimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore realizohen nga institucioni (UAMD) me korrektësi maksimal.</p> <p>Evidencë-5-Rregullore UAMD</p> <p>Evidencë-51-Numri i Personelit Akademik Efektiv dhe me Kontratë në Njësinë Bazë, 2022-2023.</p> <p>Evidencë-124-Syllabuset e Lëndëve</p>															
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që</p>	<p>UAMD dhe FE ndjek rekrutimin e personelit akademik në përputhje me bazën ligjore në fuqi, me rregulloren dhe statutin e institucionit. Zbatohen procedura të ndershme dhe transparente për rekrutimin dhe zhvillimin e personelit akademik. Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me</p>															




<p>garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>konkurs. Zyra e burimeve njerëzore UAMD mban dhe ruan një bazë të plotë dhe të qartë të raporteve të rekrutimit të stafit akademik, njoftimeve për punë, konkurseve, etj. Personeli akademik, me kohë të plotë dhe të pjesshme, që angazhohet në realizimin e mësimdhënies në programin e studimit MP plotëson të gjitha kërkesat ligjore në fuqi në lidhje me kualifikim dhe pranimin e personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme. Për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve Njësia Kryesore ngre një komision ad-hoc i që vlerëson kandidatët në dy faza:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përmes vlerësimit të dosjes;</li> <li>• përmes intervistës;</li> </ul> <p>UAMD përdor formularë aplikimi të unifikuar në nivel institucional ndërsa vlerësimi i kandidateve bëhet sipas Çelësit të vlerësimit të paketës së aplikimit. Zyra e burimeve njerëzore mban dhe ruan një bazë të plotë dhe të qartë të raporteve të rekrutimit të stafit akademik, njoftimeve për punë, konkurseve, etj.</p> <p>Evidencë-3-Statuti UAMD</p> <p>Evidencë-105-Rregullore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet për programin e studimit Master profesional “Mësues i Gjuhës Angleze” pasi në kurrikulën e këtij programi studimi nuk parashikohet zhvillimi i orëve laboratorike.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e</p>	<p>GVJ zhvilloi takim me përfaqësuesen e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore. GVJ konstaton se institucioni disponon dokumentacion të plotë për çdo anëtar të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe personelit ndihmës mësimor dhe administrativ të angazhuar në këtë program studimi. Ky dokumentacion gjendet në Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe</p>

<p>personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>pranë departamentit të Gjuhëve të Huaja. Këto dosje pasuroheshin çdo vit akademik me të dhëna të përditësuara për të gjithë elementët që kërkohen nga rregulloret përkatëse. Informacioni administrohet duke respektuar konfidencialitetin e të dhënave personale dhe arkivohen konform akteve rregullatore institucionale. Departamenti i Gjuhëve të Huaja bazohet në Rregulloren e Fakultetit të Edukimit, Rregulloren e Programit dhe Rregulloren e Zyrës së Burimeve Njerëzore.</p> <p>Evidencë-5-Rregullore UAMD.</p> <p>Evidencë-15-Rregullore, Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2019.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>UAMD bazuar në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, Standardi I.2, ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani apo palë të treta në funksion të realizimit të programit MP në “Mësues i Gjuhës Angleze”. Departamenti i Gjuhëve të Huaja në zbatim të programit të studimit ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me DAR Durrës për të kryer praktikën profesionale. Kjo praktikë mbikqyret nga personel i kualifikuar Pedagogu mbikëqyrës ndjek zhvillimin korrekt të praktikës profesionale në shkollat pritëse dhe jep vlerësimin e tij në përfundim të kryerjes së praktikës nga ana e studentit.</p> <p>Evidencë-5-Rregullore UAMD.</p> <p>Evidencë-15-Rregullore, Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2019.</p> <p>Evidencë-61-Kodi i Cilësisë.</p>
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e</p>	<p>Referuar dokumentave të paraqitura dhe takimit në institucion GVJ konstaton se studentët e programit orientohen e këshillohen gjatë praktikës profesionale nga mësueit mentorë të shkollave pritëse. Duke respektuar marrëveshjen me DAR Durrës studentëve ju krijohet mundësia e kryerjes së praktikave profesionale në fushën e mësimit, e marrjes së këshillave nga mësuesit si dhe vlerësimin të performancës së tyre nga personeli pritës.</p> <p>Evidencë-77-Marrëveshje Bashkëpunimi me DAR</p> <p>Evidencë-132-Dosja e Praktikës MP “Mësues i Gjuhës Anglez</p>

vlerësimin të tyre për praktikën profesionale.									
<b>Konkluzione</b>	<p>Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme i angazhuar në realizimin e programit të studimit MP ka kualifikimin e duhur akademik dhe ka së paku gradën shkencore "Doktor". Rreth 84% e programit zhvillohet nga personel akademik efektiv. Personeli akademik është i qëndrueshëm dhe kontribuon në funksionimin e këtij programi.</p> <p>Rekrutimi i stafit të ri bëhet mbi kriteret që shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Zyra e burimeve njerëzore ndjek dhe përditëson dokumentacionin për personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrative në përputhje me rregulloret përkatëse. DGjH mbikqyr zhvillimin e praktikave profesionale një personel të mjaftueshëm e të kualifikuar efektiv.</p> <p>GVJ konstaton se ky standard përmbushet plotësisht.</p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Veprimtaria mësimore e PS MP zhvillohet në Godina Qendrore (Currila) me sipërfaqe 6000 m <sup>2</sup> , bibliotekë dhe laboratorë. FE e zhvillon veprimtarinë e vet në sipërfaqe auditorësh ne total prej 2299.57 m <sup>2</sup> , 398 m <sup>2</sup> janë laboratorë dhe 764.02 m <sup>2</sup> janë zyra. Fakulteti i Edukimit ka në dispozicion të stafit dhe të studenteve 23 auditorë. Këto mjedise janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për numrin e studentëve, grupeve mësimore dhe në përputhje me specifikën që kanë lëndët dhe modulet e këtij programi studimi. Gjithashtu në dispozicion të programit MP gjenden edhe dy klasa laboratorike të përshtatshme për zhvillimin e mësimin, të cilat janë mundësuar falë bashkëpunimit më aktorë të tretë.






	<p>Evidencë-85-Infrastruktura në Funksion të Programit të Studimit.</p> <p>Evidencë-86-VKM nr.418, “Për Standardet, Kriteret dhe Procedurat për Hapjen, Riorganizimin e Programeve, dt. 10.5.2017.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies, UAMD ka krijuar mundësinë dhe i ka pajisur mjediset e tij mësimore si salla leksioni e auditorë, të cilat janë të favorshme për përdorimin e pajisjeve moderne elektronike si projector internet, kompjutera, laptop, etj.</p> <p>Gjatë takimit GVJ konstatoi se në ndihmë të stafit akademik, për një vlerësim sa më transparent dhe të shpejtë të studentëve përdoret programi Cleanscore dhe sistemi Pitagora. GVJ në takim me pedagogë dhe studentë vë re se studentët dhe pedagogët e përdorin me lehtësi sistemin Pitagora dhe theksojnë se ky system ka lehtësuar punën dhe ka rritur transparencën.</p> <p>Gjatë vizitës në ambientet e FE u konstaua se sallat nuk janë plotësisht të pajisura me mjete audiovizuale në shërbim të mësimdhënies.</p> <p><i>GVJ sugjeron që mjediset mësimore të pajisen me plotësisht me mjete mjete audiovizuale, për të lehtësuar zhvillimin e mësimin në auditor.</i></p> <p><i>Evidencë-106- Komunikim për përdorimin e Sistemit PITAGORA (RASH)</i></p> <p>Evidencë-107-Përdorimi i CLEANSCORE në Testime.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Auditorët në shërbim të këtij programi kanë kapacitet të bollshëm për 50 deri ne 120 studentë. Janë në dispozicion të stafit akademik 2 zyra, të cilat janë të pajisura me kompjuter që janë të lidhur në sistem interneti, gjë e cila bën të mundur komunikimin e shpejtë dhe cilësor të tyre. Ka vetëm dy laboratorë për këtë program, por ato nuk plotësojnë mjaftueshëm nevojat e gjithë studentëve.</p> <p><i>GVJ sugjeron që institucion të punojë për pajisjen e gjithë auditoreve me mjete audiovizuale.</i></p> <p>Evidencë-85-Infrastruktura në Funksion të Programit të Studimit.</p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti i Gjuhëve të Huaja, në përputhje me fushën e studimeve që ofron dhe natyrën e programit pranë tij ka në funksion të tij në gjendje të plotë një laborator ku realizohen aftësitë e të dëgjuarit e të folurit. Ky laborator i vjen në ndihmë procesit mësimor që zhvillohet në këtë program studimi.</p> <p>Evidencë-57-Tabela e Kapaciteteve, 2019-2020</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Nisur nga natyra e këtij programi në Mësuesi, UAMD ka mundësuar mbarëvajtjen e praktikave mësimore në bashkëpunim me institucione e subjekte të tjera, me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi. Në rastet kur numuri i studentëve është më i lartë se mundësitë e institucioneve të rajonit për krijimin e kushteve optimale për kryerjen e praktikës profesionale, UAMD bashkëpunon me DAR të rretheve të tjera për zhvillimin e kësaj praktike, duke siguruar një mbikqyrje dhe mbështetje të vazhdueshme nga personeli akademik.</p> <p>Evidencë-77-Marrëveshje Bashkëpunimi me DAR.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Departamenti i Gjuhëve të Huaja ka mjedisë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike brenda auditorëve në përputhje me specifikën që kanë lëndët e këtij programi studimi dhe numurin e studentëve.</i></p> <p><i>Një pjesë e mjedisëve janë pajisur me pajisjeve moderne elektronike si projektor, internet, laptop, etj. Përdoren teknologji bashkëkohore për vlerësim. Departamenti i Gjuhëve të Huaja, në përputhje me fushën e studimeve që ofron dhe natyrën e programit ka në funksion të tij në gjendje të plotë një laborator ku realizohen aftësitë e të dëgjuarit e të folurit. DGjH</i></p>




	<i>bashkëpunon me DAR për zhvillimin me cilësi të praktikës profesionale të studentëve.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>		<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë dhe ndihmëse për secilën lëndë është pasqyruar në syllabusin e lëndës, të cilat miratohen në fillim të vitit akademik dhe ju vihen në dispozicion studentëve nëpërmjet bibliotekës online. Literatura bazë dhe e rekomanduar është e përshtatshme që studentët të fitojnë njohuritë e parashikuara të programit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton literatura është në anglisht, në përputhje me gjuhën e programit, përveç atyre lëndëve që zhvillohen në gjuhën shqipe.  Evidencë-98-Biblioteka  Evidencë-124-Syllabuset e Lëndëve.  Online- <a href="https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare">https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare</a>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.	Referuar RVB miratimi dhe përditësimi i literaturës së detyrueshme bëhet në Departament dhe gjen pasqyrim në syllabusin e lëndës përkatëse. Syllabusi, i cili përfaqëson literaturën e rekomanduar të përmisuar, miratohet në departament në fillim të semestrit. GVJ konstaton se literatura e detyrueshme në syllabuset e këtij programi është me botime të pesë viteve të fundit.  Evidencë-124-Syllabuset e Lëndëve.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të	UAMD vë në dispozicion të studentëve dhe personelit dhe studjuesve Bibliotekën Shkencore, e cila gjendet në mjediset e Universitetit në të tri godinat e UAMD. Ka bashkëpunim me biblioteka të tjera akademike brenda dhe jashtë vendit dhe bën shkëmbime të informacionit. Biblioteka mundëson një fond të gjerë të literaturës në fusha gjithëpërfshirëse, i cili është




<p>barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>përpunuar sipas standardeve. Biblioteka bashkëpunon dhe përfiton publikime nga instituti UNRISD, në Zvicër. Gjithashtu, ofron mundësi kërkimi të informacionit on-line, në sallën e leximit, pranë kompjuterave të sallës, si edhe lehtësi në kërkimin bibliografik të informacionit.</p> <p>Evidencë-96-Rregullore e Bibliotekes.</p> <p>Evidencë-97-Biblioteka Online-Manual Përdorimi</p> <p>Evidencë-102-Plani-Strategjik i Bibliotekë UAMD, 2015-2020</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka universitare ofron literaturë bashkëkohore, tekste mësimore dhe plotësuese, kryesisht në përputhje me kurrikulat mësimore, me një numër të kopjeve për çdo titull nga 2-5 kopje mesatarisht ndërsa kopjet e librit të huaj variojnë nga 1- 2 kopje. Krahas librit fizik, ekziston edhe libri elektronik, (mbi 10000 tituj). Aktualisht në UAMD janë funksionale 3 biblioteka. Koleksioni i tyre përfshin burime që pjeserisht plotësojnë nevojat e përdoruesve të saj si nga përmbajtja ashtu dhe nga forma. Çdo vit akademik parashikohen fonde për blerjen e literaturës shkencore. Biblioteka posedon një literaturë gjithëpërfshirëse, duke mbështetur të gjitha programet e studimit në UAMD. GVJ konstaton që vitet e fundit biblioteka nuk është pasuruar me fond shtesë të literaturës fizike, por vetëm me fond elektronik (JSTOR, EBSCO, COBISS). GVJ vlerëson se ka abonime në biblioteka online prestigjioze dhe hapjen e llogarisë për secili pedagog dhe student për shfrytëzimin e burimet të duhura.</p> <p>Gjithashtu, GVJ konstaton se nuk ka asnjë libër fizik për lëndët e kësaj kurrikule në bibliotekë.</p> <p><i>GVJ sugjeron që Institucioni duhet të sigurojë fonde për blerjen e titujve për këtë program studimi.</i></p> <p>Evidencë-98-Biblioteka Online</p> <p>Evidencë-100-Të Dhëna për Bibliotekën</p> <p>Evidencë-102-Plani-Strategjik i Bibliotekë UAMD, 2015-2020</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në</p>	<p>GVJ konstaton se biblioteka plotëson pjesën më të madhe të nevojave të studentëve për literaturë bazë dhe ndihmëse. Ky shërbim është i barabartë dhe për të gjithë studentët apo personelin. Çdo student apo pedagog ka të drejtën e anëtarësimit falas në bibliotekë. Ata disponojnë një kartelë regjistrimi me të</p>




bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	dhënat personale dhe pajisen me librezë anëtarësie. GVJ vlerëson krijimin e një databaze elektronike nga biblioteka e UAMD-së që ndihmon personelin dhe studentët të gjejë libra online, të shkarkojë falas artikuj shkencorë sipas kërkesëve të tyre.  Evidencë-96-Rregullore e Bibliotekës
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Në bazë të nenit 6 pika 64, të Rregullores së Bibliotekës, biblioteka ofron shërbimet e saj përmes ambienteve Salla me fond të Hapur, pajisur me PC që kanë të instaluar programe specifike sipas profilit të studimit, ku studentët mund të realizojnë detyrat e tyre.  Evidencë-96-Rregullore e Bibliotekës
<b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Referuar RVB Biblioteka e UAMD klasifikohet si Bibliotekë Universitare. Kjo bibliotekë është e hapur edhe në fundjavë, për t'u ardhur në ndihmë studentëve dhe stafit akademik të ciklit të dytë të studimit për nevojat dhe kërkesat e tyre. Oraret e bibliotekës janë të paraqitura në të gjitha mjediset e institucionit dhe në web-in e universitetit.  Evidencë-99-Evidencë që Biblioteka funksionon edhe në Fundjavë
<b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe	Biblioteka e UAMD pasurohet me literaturë të detyrueshme dhe të rekomanduar në mënyrë të vazhdueshme. Kërkesat e bibliotekës për pasurim të literaturës rrjedhin nga bashkëpunimi i saj me fakultetet. Biblioteka dorëzon pranë drejtorisë së menaxhimit financiar kërkesat e saj për blerje librash, materiale, skanera kompjuterë, etj.  Megjithatë, bazuar në vizitën në institucion, GVJ konstaton që pasurimi i bibliotekës nuk është periodik, por varet nga mundësitë buxhetore të UAMD dhe kryhet nëpërmjet: blerjeve, dhurimeve, shkëmbimit të materialeve mes bibliotekave, artikujve shkencorë, tezave dhe dizertacioneve.  <i>GVJ sugjeron forcimin e rolit të bibliotekës së UAMD dhe pasurimin e saj me më shumë libra fizike të viteve të fundit si dhe rishikimit të zërit të buxhetit që shkon për pasurimin e fondit të bibliotekës.</i>  Evidencë 34 - Rregullorja e Bibliotekës






atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.									
<b>Konkluzione</b>	<p><i>PS përmban literaturë të botimeve të 5 viteve të fundit, e cila ofrohet në gjuhën angleze, gjuha e programit, gjë që e bën më të lehtë aksesin e saj në format elektronik. Miratimi dhe përditësimi i literaturës së detyrueshme bëhet në departament.</i></p> <p><i>IAL disponon një bibliotekë fizike e cila funksionon edhe gjatë fundjavës dhe disa biblioteka online, që ofrojnë shërbim të barabartë për të gjithë përdoruesit e saj.</i></p> <p><i>GVJ vlerëson krijimin e një databaze elektronike, bashkëpunimin dhe abonimet në biblioteka on line prestigjioze dhe hapjen e llogarisë për secilin pedagog dhe student për të shfrytëzuar burimet e kërkuara.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se nuk ka asnjë libër fizik për lëndët e kësaj kurrikule në fondin e bibliotekës. <u>GVJ sugjeron që duke marrë parasysh rëndësinë e këtij PS për përgatitjen e mësuesve të kushtojë vëmendje të vecantë rishikimit të zërit të buxhetit që shkon për pasurimin e fondit të bibliotekës.</u></i></p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në	GVJ konstaton se Institucioni ka një sistem menaxhimi efektiv për administrimin e informacionit për studentët. Përdoret Pitagora të zhvilluar dhe administruar nga RASH i cili aksesohet online në <a href="https://uamd.pitagora.rash.al/login">https://uamd.pitagora.rash.al/login</a> . Sistemi ndihmon institucionin për administrimin e informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim. Gjithashtu janë regjistri i arritjeve akademike të studentit, i cili

<p>diplomim në programin e studimit.</p>	<p>vërteton arritjet e studentit gjatë aktivitetit të tij akademik dhe regjistri i lëshimit të diplomave dhe çertifikatave që vërteton lëshimin e çertifikatave dhe diplomave.</p> <p>Evidence-69-Rregullorja për Arshivimin e Dokumentacionit</p> <p>Evidencë-106- Komunikim për përdorimin e Sistemit PITAGORA (RASH).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit Pitagora përdoret nga studentët, pedagogët, financa dhe sekretaria respektivisht sipas roleve që ato kanë në institucion.</p> <p>Çdo përdorues/rol në sistemin Pitagora ka akses të dedikuar për të dhënat që kanë lidhje me aktivitetin e tij në FE/UAMD:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Studentët kanë akses në kurrikulat e tyre, vlerësimin për kurset e frekuentuara dhe provimet, regjistrimin dhe të dhënat e orarit mësimor etj.</li> <li>- Personeli akademik ka akses te regjistrat e seksioneve që mbulon, procesverbalet e vlerësimit të studentëve, orarin mësimor etj.</li> <li>- Sekretaria mësimore ka akses të dedikuar për orarin mësimor, listat e studentëve të regjistruar në orar, të dhënat e studentëve dhe vlerësimet e tyre, të dhënat për personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie etj.</li> <li>- Dega ekonomike ka akses në të dhënat e studentëve përsa i përket tarifave të studimit dhe pagesave të kryera.</li> </ul> <p>Evidencë-16-CV-të e Personelit Akademik</p> <p>Evidencë-54-Ngarkesa Mësimore e Personelit Akademik në të Gjitha Programet, 2021-2022.</p> <p>Evidencë-105-Rregullore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit funksionon në bazë të roleve dhe të drejtave të përdoruesve, të cilët pasi logohen me anë të emailit dhe fjalëkalimit kanë akses në të dhënat e tyre sipas rolit që kanë në institucion. Në këtë mënyrë administrohen të dhënat e studentëve dhe i ofrohet atyre një hapësirë private për të aksesuar notat, ndërtuar orarin, regjistruar modulet, riprovimet etj. Në këtë mënyrë garantohet privatësia e të dhënave personale dhe liria akademike sipas legjislacionit në fuqi. Të dhënat dhe informacionet janë të kufizuara vetëm brenda aktivitetit që</p>

	<p>përdoruesit zhvillojnë në UAMD duke ruajtur konfidencialitetin e çdo studenti ose anëtari të personelit të FE. Të dhënat janë të ruajtura dhe mund të aksesohen për të gjitha vitet që përdoruesi është pjesë e FE.</p> <p>Evidencë-103-Rregullore e Sektorit të Teknologjisë dhe Informacionit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. Njëpërmjet sistemit PITAGORA studentët marrin informacion në kohë reale për vlerësimet gjatë semestrit, vlerësimin në provim dhe vlerësimin personal, si dhe të dhëna për rregjistrimet, provimet , notën përfundimtare etj.</p> <p>GVJ vlerëson pozitivisht edhe format e tjera të komunikimit interaktiv (si GoogleDrive, Goggle Classroom, Zoom apo adresave email, rrjete sociale ) që institucioni përdor për t’iu përgjigjuar studentëve dhe për të arritur një komunikim sa më të shpejtë me ta. Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua si nga pedagogët edhe personeli se sistemi Pitagora u duket i lehtë në përdorim dhe mbështetës. Në lidhje me komunikimin e stafit me studentët përdoren adresa elektronike personale. GVJ konstatoi se edhe në syllabuset e dorëzuara dhe CV-të e pedagogëve ata përdorin adresa elektronike personale, gmail, yahoo etj, jo adresë institucionale. Këtë e shpjegojnë me probleme të ndryshme teknike të ndeshura më parë .</p> <p><i>GVJ sugjeron që institucioni të mundësojë një komunikim interaktiv dhe shkëmbim të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve nëpërmjet funksionimit të postës elektronike zyrtare efektive.</i></p> <p>Evidencë-6-Platformat Google Classroom dhe Zoom</p> <p>Evidencë-103-Rregullore e Sektorit të Teknologjisë dhe Informacionit</p> <p>Evidencë-106- Komunikim për përdorimin e Sistemit PITAGORA (RASH)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e</p>	<p>Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të informacionit që lidhen më procesin mësimor dhe zbatimin e programit nga ana e personelit akademik.</p>

<p>administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>DGjH në analizat e punës mësimore dhe kërkimore mbështetet në të dhënat që gjenerohen nga sistemi si të dhëna në lidhje me kalueshmërinë, notën mesatare, përdorimin e ambienteve didaktike, etj.</p> <p>Evidencë-5-Rregullore UAMD</p> <p>Evidencë-92-Raporti mbi Veprimtarinë Mësimore-Shkencore të Departamentit, 2021-2022</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>UAMD përmes faqes zyrtare jep informacion për fakultetet, ciklet dhe programet e studimit që ofron, revistën shkencore, librarinë, Statutin dhe Rregulloret e funksionimit të tij, të dhëna statistikore për numrin e studentëve, të dhëna për stafin akademik, njoftime etj. Të gjitha informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internet të UAMD (uamd.edu.al), në dy gjuhë, në shqip dhe anglisht si dhe në rrjetet sociale zyrtare te UAMD.</p> <p>facebook: Universiteti “Aleksandër Moisiu”</p> <p>Instagram: uamdoofficial</p> <p>Facebook: Fakulteti Edukimit</p> <p>Facebook: Departamenti i Gjuhëve të Huaja</p> <p>Evidencë-111-Të Dhëna nga Eëbsite-i i UAMD-së</p> <p>Evidencë-113-Të Dhëna nga faqja Facebook e FE</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni ka një sistem menaxhimi efektiv për administrimin e informacionit për studentët. Nëpërmjet sistemit Pitagora menaxhohen të dhënat e studentëve.</i></p> <p><i>UAMD ka sistemin e brendshëm të menaxhimit, i cili nëpërmjet strukturave përkatëse administron informacionin dhe dokumentacionin për aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, sistem që garanton monitorim në kohë reale të informacionit që lidhet më procesin mësimor dhe zbatimin e programi. Të gjitha informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit të UAMD, në dy gjuhë, në shqip dhe anglisht.</i></p>

	<i>GVJ konstaton se personeli i këtij institucioni nuk përdor me efikasitet adresat e postës elektronike zyrtare të institucionit, por përdor adresa personale.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ vëren që UAMD harton projekt buxhetin duke marrë në konsideratë realizimin e objektivave të universitetit, konform legjislacionit në fuqi, dhe ka raporte financiare që hartohen në nivel institucional. Raportet detajojnë të ardhurat nga burime të ndryshme dhe kostot për studentët e cikleve të studimit Bachelor, Master profesional dhe Master i Shkencave.  Evidencë-114- Miratimi i Raportit të Aktivitetit Vjetor të UAMD.  Evidencë-116-Të Dhëna Financiare rreth Kostove të Programit MP “Mësues i Gjuhës Angleze”.






<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Sipas DVV plani financiar detajon kostot për të gjithë zërat në shërbim të realizimit të programit që nga shërbimet operative, kostot e burimeve njerëzore, shpenzimet për mirëmbajtjen e mjediseve, rritjen e numrit të stafit akademik, kualifikimin e stafit akademik; përmirësimi cilësor i laboratorëve shkencore, abonimi në revista shkencore dhe biblioteka online, përmirësimi i kushteve higjieno sanitare; pjesëmarrjes në projekte, konferenca e kongrese kombëtare e ndërkombëtare, etj.</p> <p>Në përfundim të çdo viti akademik, njësitë kryesore të UAMD dërgojnë planin strategjik ku parashikohen shpenzimet e nevojshme dhe të ardhurat. Mbi këtë bazë UAMD harton planin strategjik financiar që i paraqitet për miratim bordit të administrimit.</p> <p>Evidencë-116-Të Dhëna Financiare rreth Kostove të Programit MP “Mësues i Gjuhës Angleze</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>UAMD auditohet nga grupi i ekspertëve të auditit të brendshëm të institucionit. Janë tri burimet potenciale të financimit: Financim nga buxheti i shtetit, financim nga tarifat e studentëve si edhe financim nga shërbimet që UAMD ofron për aktorë të tretë. Pasqyra financiare e të ardhurave nga tarifat e studentëve dhe nga burimet e tjera të financimit bëhet publike në faqen web të UAMD.</p> <p>Evidencë-114- Miratimi i Raportit të Aktivitetit Vjetor të UAMD</p> <p>Evidencë-115-Raporti i Veprimtarisë Audituese, 2020-2021.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>GVJ vëren se UAMD ndjek politika për programin e transparencës me qëllim rritjen e saj në UAMD. Në faqen web të UAMD ka një sesion të dedikuar për transparencën, por për <i>sa i përket plan-buxhetit, realizimit të buxhetit dhe pasqyrave financiare informacioni mungon ose është i papërditësuar.</i></p> <p>Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti në takimin me stafin akademik, u vu re se kishte personel akademik të cilët ishin të informuar rreth mundësive të mbështetjes financiare</p>

	<p>institucionale për avancimin e tyre akademik, si mbështetje për pjesëmarrje në konferenca apo për botime në revista. Edhe pse nga organet drejtuese u bë e ditur, se ky informacion është i plotë dhe transparent duke ju vënë në dispozicion të gjithë stafit akademik, gjykojmë se institucioni duhet të përdori forma më të drejtëpërdrejta dhe transparente për informimni e stafit rreth mundësive financiare të mbështetjes së tyre. Si dhe të parashikojë kritere për aksesin në këto fonde në mënyrë transparente për të gjithë stafin e kësaj njësie kryesore.</p> <p><i>Sugjerohet që institucioni të realizojë komunikim periodik mbi parashikimet e miratuara të buxhetit afat shkurtër, kriteret dhe përzgjedhjen e shpërndarjes së fondeve të dedikuara për kërkimin shkencor. Ky komunikim të realizohet me mjete transparente jo vetëm në mbledhje të njësisë bazë por edhe me komunikime me postë elektronike (mailing list) të të gjithë stafit.</i></p> <p>Evidencë-115-Raporti i Veprimtarisë Audituese, 2020-2021.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Drejtoria e Administrimi Financiar ndjek zbatimin e të gjitha procedurave financiare të lidhura me planifikimin dhe realizimin e buxhetit në UAMD-së.</p> <p>Te ardhurat e UAMD-se kanë pësuar rritje të vazhdueshme gjatë viteve të fundit. Në të ardhurat që vetë UAMD gjeneron, rreth 20% burojnë nga tarifa e shkollimit. Dokumentacioni dhe takimet e kryera garantojnë stabilitetin financiar të këtij programi studimi. Mbështetur në raportet financiare vjetore dhe në analizën e menaxhimit të riskut, institucioni ka kapacitet të sigurojë qëndrueshmëri financiare të programit të studimit si dhe merr në konsideratë analizat për mjaftueshmërinë e kapaciteteve financiare për përmirësimin e situatës financiare në të ardhmen.</p> <p>Evidencë-111-Të Dhëna nga Eëbsite-i i UAMD-së</p> <p>Evidencë-114- Miratimi i Raportit të Aktivitetit Vjetor të UAMD.</p> <p>Evidencë-116-Të Dhëna Financiare rreth Kostove të Programit MP “Mësues i Gjuhës Angleze”</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UAMD si institucion publik i arsimit të lartë garanton financim dhe mbështetje financiare nga buxheti i shtetit dhe mbështetje</i></p>

	<p><i>alternative nga burime të tjera. Të ardhurat financiare në tërësi kanë pësuar rritje gjatë viteve të fundit.</i></p> <p><i>Programi MPnë Mësues i Gjuhës Angleze ka treguar qëndrueshmëri të të ardhurave që burojnë nga tarifa e shkollimit. Plani financiar i departamentit mbulon të gjithë zërat në shërbim të realizimit të programit. UAMD auditohet nga grupi i ekspertëve të auditit të brendshëm të institucionit në mënyrë periodike. GVJ konstaon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka hartuar dokumentacionin e nevojshëm ku mbështeten procedurat për ciklin e dytë të studimit, nga regjistrimi i studentëve deri në diplomim. Në rregulloret përkatëse përshkruhet procesi i regjistrimit të studentëve, i zhvillimit të procesit mësimor, i transferimit të studimeve, njohjes dhe njehsimit të diplomave, procedura e ankimimit dhe diplomimit të tyre. Përveç kësaj, Institucioni krijon kushtet e përshtatshme që studentët të orientohen dhe informohen rregullisht dhe saktë, duke siguruar një proces legjitim dhe korrekt informimi. GVJ vlerëson se dokumentat bazë të hartuara janë në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e</p>




	<p>Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe zbatimit të udhëzimeve e MASR nr.10 datë 15.05.2019, nr.17 datë 30.07.2019.</p> <p>Evidencë-5-Rregullore UAMD.</p> <p>Evidencë-9-Rregullore FE, 2019</p> <p>Evidencë-15-Rregullore, Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2019.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se procedurat e miratuara dhe të zbatuara garantojnë barazinë për çdo student. Kjo evidentohet në dhënien dhe marrjen e informacionit të duhur në lidhje me Rregulloren e Institucionit, Rregulloren e programit të studimit, procesin mësimor si dhe çdo procedurë që lidhet me të, në kriteret që përdor njësi bazë për pranimin e studentëve në program; në përdorimin e infrastrukturës dhe ambienteve të tjera në kampus. Gjithashtu procedura e përfitimi të bursave në UAMD është e barabartë për të gjithë studentët bazuar në meritën e përfitimit sipas politikave shtetërore për bursat studentore për shtetas në nevojë si dhe për studentët me rezultate të larta akademike.</p> <p>Evidencë-3-Statutii UAMD, 2018, Neni 57, 58, 64, 89</p> <p>Evidencë-5-Rregullore UAMD, Kreu III, Neni 46</p> <p>Evidencë-9-Rregullore FE, 2019, Seksioni IV, Neni 27</p> <p>Evidencë-15-Rregullore, Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2019</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>GVJ konstaton se ndiqen me korrektësi procedurat e miratuara për përzgjedhjen e kandidatëve në programin e studimit. DGjH propozon kriteret e pranimit të studentëve në ciklin e dytë të studimeve si dhe kuotat, të cilat pasi miratohen nga Dekanati i Fakultetit dhe Senatit Akademik, publikohen online në faqen zyrtare të Institucionit përpara fillimit të vitit akademik. Po kështu, Departamenti i Gjuhëve të Huaja publikon online në faqen zyrtare të Institucionit fituesit në MP Mësues i Gjuhës Angleze si dhe bën shpalljen e tyre në ambientet e brendshme të Fakultetit të Edukimit.</p> <p>Evidencë-59- Vendim Senati për Kuotat, 2023-2024</p> <p>Evidencë-60-Kriteret e Pranimit UAMD.</p>

	Evidencë-64-Shpërndarja e kuotave në programin “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2020-2021
<b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	<p>Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstatoi se FE u vë në dispozicion informacion të plotë në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Ky informacion është qartësisht i shprehur në rregulloret e institucionit. Departamenti i Gjuhëve të Huaja publikon online në faqen zyrtare të institucionit fituesit si dhe bën shpalljen e tyre në mjediset e brendshme të Fakultetit të Edukimit. <i>GVJ sugjeron bërjen publike të rregulloreve institucionale në faqen zyrtare të IAL në mënyrë që të jenë më lehtë të aksesueshme nga të gjithë të interesuarit.</i></p> <p>Evidencë-15-Rregullore, Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”</p> <p>Evidencë-109-Programi i Transparencës UAMD</p> <p>Evidencë-111-Të Dhëna nga ëbsite-i i UAMD-së.</p>
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	<p>Nga shqyrtimi i DVV dhe takimeve në institucion rezulton se FE në bashkëpunim me zyrat përkatëse në UAMD ka në dispozicion informacion të plotë në lidhje me kriteret e procedurat e pranimit të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Ky informacion është qartësisht i shprehur në rregulloret e institucionit. Për sa i përket kriterëve dhe procedurave të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, ato janë të shprehura në rregulloren e IAL dhe rregulloren e njësisë kryesore.</p> <p>Ky informacion shpërndahet përmes faqes zyrtare të ëbsite-it zyrtar (<a href="https://ëëë.uamd.edu.al/">https://ëëë.uamd.edu.al/</a>) në fillim të çdo viti akademik si dhe në rrjetet e tjera sociale si Facebook. Përveç kësaj, çdo njësi ndjek një politikë marketingu duke organizuar grupe pune detyra e të cilave është të promovojnë programet e ofruara nga kjo njësi. Një nga këto veprimtari është edhe Open Days të organizuara nga Institucioni.</p>
	<p>Evid. 3. Rregullore UAMD – Neni 56,</p> <p>Evid. 4. Rregullore FTI – Neni 38 dhe Neni 39</p> <p>Evid. 30. Urdhër Koordinatorët dhe NJSBC</p>



	<a href="https://uamd.edu.al/informacione-dhe-dokumenta/">https://uamd.edu.al/informacione-dhe-dokumenta/</a>
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	<p>Institucioni harton dhe publikon kriteret e pranimit përpara çdo viti akademik. Kuotat dhe kriteret e pranimit të propozuara nga Njësia Bazë, pasi kanë marrë miratimin e Dekanatit të Fakultetit dhe Senatit Akademik, publikohen online në faqen zyrtare të Institucionit përpara fillimit të vitit akademik. Po kështu, Departamenti i Gjuhëve të Huaja publikon online në faqen zyrtare të Institucionit fituesit në MP Mësues i Gjuhës Angleze si dhe bën shpalljen e tyre në ambientet e brendshme të Fakultetit të Edukimit. Çdo vit akademik parashikohen kuota të synuara për kandidatë të kategorive të veçanta</p> <p>Evidencë-13-Rregullore për Studentët me Aftësi të Kufizura.</p> <p>Evidencë-60-Kriteret e Pranimit UAMD</p> <p>Evidencë -61-Vendim Senati për Kriteret e Pranimit te Studenteve</p> <p><a href="https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit/">https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit/</a></p>
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	<p>Ndonëse kriteret e përzgjedhjes së studentëve për të ndjekur masterin profesional në “Mësues i Gjuhës Angleze” janë të njëjta për të gjithë aplikantët, kuotat e dedikuara për këtë kategori dhe aplikimet bëhen sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit.</p> <p>Evidencë-64-Shperndarja e kuotave në programin “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2020-2021.</p>
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	<p>UAMD aplikon politikat shtetërore për bursat studentore për shtresat në nevojë dhe për studentët me rezultate të larta akademike, krahas kategorive të studentëve me aftësi të veçanta, pakicave dhe shtresave të marginalizuara dhe shtetasve të huaj.</p> <p>Evidencë-64-Shperndarja e kuotave në programin “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2020-2021</p>
<b>Konkluzione</b>	<i>UAMD ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit MP në përputhje me dispozitat ligjore. Studentëve ju garantohet barazia në marrjen e informacionit për rregulloret e miratuara,</i>




	<p><i>procedurat, kriteret e pranimit, përdorimit të infrastrukturës dhe ofrimit të shërbimeve.</i></p> <p><i>UAMD zbaton politikat shtetërore dhe ofron bursa studimi për shtresat në nevojë. Këto bursa aplikohen edhe për studentët me rezultate të larta akademike. GVJ konstaton se për sa më sipër ky standard përmbyset plotësisht.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbyshjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbyset</b>	<b>Përmbyset pjesërisht</b>	<b>Përmbyset kryesisht</b>	<b>Përmbyset plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVD GVJ konstaton se Institucioni jep informacionin të nevojshëm për kriteret dhe procedurat e vlerësimit të përparimit të studentëve. Kështu, respektohet tërësia e kriterëve të përcaktuara në Rregulloren e Institucionit, Rregulloren e Fakultetit të Edukimit, Rregulloren e Departamentit si dhe në Rregulloren e Programit të Ciklit të Dytë të Studimeve. Analiza e pyetësorëve që plotësojnë studentët mbi vlerësimin e programit të studimit jep të dhëna se ata janë të informuar për kriteret e kalimit në vitin pasardhës. Gjatë takimit me studentët e programit Master GVJ konstatoi se atyre u bëhen të njohura kriteret për vlerësimin dhe përparimin e tyre gjatë takimeve të tyre me Drejtuesin e Njësisë Bazë.</p> <p>Evidencë-5-Rregullore UAMD, Kreu III, Nenet 45, 46, pika 9, 51, 54, 56 dhe 59.</p> <p>Evidencë-9- Rregullore FE, 2019, Seksioni IV, Nenet 23 dhe 28, pika 3, Nenet 33, 38 dhe 41</p> <p>Evidencë-15-Rregullore Master Profesional Mësues i Gjuhës Angleze, Kreu II, Neni 13.</p> <p>Evidencë-82-Formular i Vlerësimit të Programit të Studimit</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje</p>	<p>UAMD ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve për të gjithë ata që gëzojnë statusin e studentit,</p>





<p>me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda tij, apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë. Transferimet lejohen në të njëjtin cikël studimi e në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik. Fakulteti i Edukimit, me anën e rregulloreve të miratuara vë në dispozicion kurrikulën e studimeve, planin mësimor, modulet dhe programin lëndor (syllabusin), ku përcaktohen objektivat e lëndëve, literatura e detyrueshme dhe ajo e sugjeruar, temat, orët e leksioneve/seminareve, organizimin në semestra si dhe kohëzgjatjen e kursit.</p> <p>Evidencë-15-Rregullore Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, Kreu IV, Neni 23.</p> <p>Evidencë-109-Programi i Transparencës UAMD, <a href="http://ëëë.uamd.edu.al/">http://ëëë.uamd.edu.al/</a>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi gjatë takimit me studentët se ata kanë informacion të plotë për procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të tyre. Në javën e para të mësimit ata informohen nga pedagogu përkatës kur prezantohet plani mësimor të lëndës së tij. Gjithashtu gjatë javës së orientimit studentët informohen në auditor nga drejtuesi i departamentit. Vlerësimi i dijeve është i unifikuar në nivel IAL dhe sanksionohet në rregulloren e UAMD dhe rregulloren e FE Rregulloren e Masterit Profesional të Gjuhëve të Huaja si dhe Rregulloren e Departamentit.</p> <p>Evidencë-5-Rregullore UAMD, Kreu III, Neni 46, 51, 57, 58, 60, 83 dhe Neni 89.</p> <p>Evidencë-9- Rregullore FE, 2019, Seksioni IV, Neni 23, 27, 28, 39 dhe Neni 40. Seksioni V, Neni 59.</p> <p>Evidencë-12-Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, Seksioni IV, Neni 18, Neni 19. Seksioni XI, Neni 42, gërma i dhe j.</p> <p>Evidencë-32- Java e Orientimit dhe Guida e Studentit</p> <p><a href="https://uamd.edu.al/informacione-dhe-dokumenta/">https://uamd.edu.al/informacione-dhe-dokumenta/</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe</p>	<p>Në takimin me studentët GVJ konstatoi se studentët ishin të mirëinformuar për kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimin e tyre në përfundim të programit të studimit. Informacioni është marrë nëpërmjet takimeve në Departament. Studentët e vitit të dytë ishin njohur me Formularin e Kërkesës</p>




<p>diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>për Tezën e Diplomës dhe Vlerësimi në kohën që u bë takimi. Institucioni i ka parashikuar procedurat dhe kriteret në Rregulloren e UAMD, Rregulloren e FE, si dhe Rregulloren e Departamentit.</p> <p>Evidencë-15-Rregullore Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”</p> <p>Evidencë-134-Manual për Shkrimin e Diplomës.</p> <p>Evidencë-135-Formulari i Kërkesës për Tezën e Diplomës dhe Vlerësimi</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët e programit Master GVJ kostatoi se studentët ishin njohur dhe informuar në disa mënyra me këtë program studimi. Kjo gjë ishte bërë e mundur që në studimet Bachelor ku atyre u ishte bërë një orientim për studimet e mëtejshme. Gjithashtu nga DVV GVJ konstaton se UAMD informon studentët e ardhshëm të programit nëpërmjet prezantimit të programit për të interesuarit gjatë Javës së Orientimit në fillim të çdo viti akademik, materialeve promovuese (fletëpalosje) për shpërndarjen e informacioni, guida e studentit, ëeb site, rrjete sociale, broshura, udhëzues të posaçëm.</p> <p>Evidenca-120-Broshura para Promovimit.</p> <p>Evidenca-122-Informacione mbi Programin e Studimit ne Facebook.pdf</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>FE dhe DGjH jep informacion të nevojshëm për kriteret dhe procedurat e vlerësimit të përparimit të studentëve.</i></p> <p><i>Departamenti informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme, vecanëstisht për kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës. Njësia bazë përdor mënyra të shumëllojshme për prezantimin e programit dhe të komunikimit si në fillim të vitit akademik ashtu edhe në mënyrë periodike.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

**Standardi V.3**




<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>GVJ konstatoi se studentët janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen, kreditet, dhe llojin e diplomës. Ky informacion jepet edhe nëpërmjet Sekretarisë mësimore si dhe takimeve që zhvillohen në Njësinë Bazë, si dhe në ditët informuese. Tërësia e këtyre akteve janë të aksesueshme në faqen zyrtare të institucionit.</p> <p>Evidencë-12-Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, Seksioni IV, Nenet 14, 15, 18 dhe 19</p> <p>Evidencë-15-Rregullore Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, Kreu II, Nenet 9, 14 dhe 15</p> <p>Evidencë-111-Të Dhëna nga ëbsite-i i UAMD-së.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>Nga shqyrtimi I DVV GVJ konstaton se informacioni i detajuar për planin mësimor, modulet dhe programin lëndor (syllabusin), ku përcaktohen objektivat e lëndëve, literatura e detyrueshme dhe ajo e sugjeruar, temat, orët e leksioneve/seminareve, organizimin në semestra si dhe kohëzgjatjen e kursit jepet në orën e parë të mësimit nga pedagogu i lëndës në të cilën prezantohet edhe plan programi i lëndës. Këto informacione të detajuara gjenden në rregulloret e miratuara të institucionit. Gjithashtu, studenti ka mundësi të informohet në lidhje me kurikulën e programit të studimit nëpërmjet faqes zyrtare të universitetit ose rrjeteve sociale të fakultetit.</p> <p>Evidencë-12-Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, Seksioni III, Nenet 20 dhe 21</p> <p>Evidencë-39-Plani Mësimor për Programin MP "Mësues i Gjuhës Angleze".</p> <p>Evidencë-109-Programi i Transparencës UAMD</p> <p>Evidencë-124-Syllabuset e Lëndëve</p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen	<p>GVJ u informua gjatë vizitë s në Institucion se informimi i studentëve mbi mundësinë e punësimit dhe orientimi i tyre drejt tregun të punës kryhet nga Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, funksionon në nivel institucional, e cila publikon</p>






<p>institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>online në Facebook dhe Instagram mundësitë e ndryshme të punësimit për studentëve të diplomuar sipas profileve përkatëse. Kjo zyrë grumbullon të dhëna për punësimin real të studentëve ndër vite, e cila e ndihmon institucionin në politikën e tij për marrëveshjet e ndryshme që nënshkruan si me subjektet shtetërore ashtu dhe ato private. Të dhëna të përditësuara dhe njoftime punësimi për studentët gjenden në faqen zyrtare të UAMD, në sektorin e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës dhe në llogarinë në facebook dhe instagram Karriera UAMD</p> <p>Evidencë-29-Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës.</p> <p>Evidencë-72-Studentë të MP “Mësues i Gjuhës Angleze” të Punësuar</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentëve u ofrohet informacioni i nevojshëm dhe i përditësuar në lidhje me procesin mësimor nga sistemi PITAGORA. Studentëve u ofrohet emri identifikues me fjalëkalimin për të hyrë në sistem, sikurse dhe manuali i përdorimit të sistemit. Gjithashtu në faqen zyrtare të UAMD. Gjenden shërbimet në funksion të realizimit të programit mësimor dhe kontaktet me administratën, sekretarinë, dhe stafin akademik përgjegjës për programin e studimit.</p> <p>Evidencë-103-Rregullore e Sektorit të Teknologjisë dhe Informacionit</p> <p>Evidencë-104-Manuali i Përdorimit të Pedagogut PITAGORA</p> <p>Evidencë-106- Komunikim për përdorimin e Sistemit PITAGORA (RASH)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit PITAGORA studentët marrin të dhëna për mësimor, planin mësimor, syllabuset e lëndëve. Ky sistem është lehtësisht i aksesueshëm online. UAMD ka përgatitur dhe publikuar në faqen zyrtare një manual për studentët për akses në sistemin Pitagora. Përdoret gjithashtu faqja zyrtare e Institucionit por edhe faqja në Facebook dhe Instagram e FE. GVJ konstaton se informacioni në lidhje me programin e studimit është i arritshëm lehtësisht nga studentët në distancë nëpërmjet lidhjes në internet.</p> <p>Evidencë-109-Programi i Transparencës UAMD</p>




	<p>Evidencë-103-Rregullore e Sektorit të Teknologjisë dhe Informacionit.</p> <p>Evidencë-111-Të Dhëna nga ëebsite-i i UAMD-së.</p> <p>Evidencë-113-Të Dhëna nga faqja Facebook e FE</p> <p>Evidencë-122-Informacione mbi Programin e Studimit në Facebook</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>UAMD përdor sistemin e brendshëm të menaxhimit Pitagora që ofrohet nga RASH dhe që mundëson aksesimin online të të dhënave në lidhje me strukturën e vitit akademik, orarin mësimor, planin mësimor, syllabuset e lëndëve. Manuali përgatitur dhe publikuar në faqen zyrtare lehtëson aksesimin e dokumentave të duhura. Gjithshtu Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës informon studentë mbi mundësinë e punësimit dhe orienton ata drejt tregun të punës.</i></p> <p><i>Sistemi PITAGORA dhe rrjetet sociale përdoren për ofrim në mënyrë të vazhdueshme të informacionit të përditësuar edhe kur studentët janë në distancë. Ky standard pë rmbushet plotësisht.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>Sekretarisa Mësimore e FE ka krijuar bazën e të dhënave mbi numrin e studentëve të regjistruar në çdo program studimi, përfshi këtu dhe programin MP “Mësues i Gjuhës Angleze”. Përveç kësaj, sekretaria disponon të dhëna mbi rezultatet e studentëve gjatë kohës së studimit si dhe numrin e studentëve të diplomuar çdo vit. Këto të dhëna institucioni i përdor për të realizuar analizat vjetore si dhe për të bërë vlerësimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p>Evidencë-5-Rregullore UAMD-, Neni 89</p>

	<p>Evidencë-9-Rregullore FE, 2019, Neni 65</p> <p>Evidencë-47-Rregullore Sekretaria</p> <p>Evidencë-79-Analiza Vjetore e Njësisë Bazë në lidhje me MP “Mësues i Gjuhës Angleze”2021-2022</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Fakulteti i Edukimit përmes Zyrës së Sekretarisë Mësimore mban, administron dhe kontrollon të dhënat e studentëve si dhe siguron informacion statistikor të plotë në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar për e programin MP “Mësues i Gjuhës Angleze” dhe ecurinë e tyre.</p> <p>Gjatë vizitës të kryer në sekretarinë mësimore GVJ konstatoi se të dhënat e studentëve mbahen në Regjistrin themeltar të studentëve, Regjistrin e arritjeve akademike, Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave.</p> <p>Në tre vitet e fundit numri i studentëve që kanë ndjekur programin është si më poshtë:</p> <p>Viti akademik 2020-2021 78 studentë;</p> <p>Viti akademik 2021-2022 66 studentë;</p> <p>Viti akademik 2022-2023 57 studentë;</p> <p>Të dhënat e plotësuar për çdo student të regjistruar janë në renditje kohore me datën e regjistrimit të studentëve. Nga verifikimet gjejnë një përputhje të notave dhe plotësimi i regjistrit është në përputhje me kuadrin ligjor. Në regjistrin e lëshimit të diplomave plotësohen të dhënat e diplomave dhe tërheqja e saj me suplementin e diplomës bëhet nga vetë studenti ose përmes një autorizimi të noterizuar. Gjithashtu, çdo vit Sekretaria Mësimore përcjell të dhëna statistikore mbi numrin e studentëve, të cilët tërhiqen pas regjistrimit sikurse dhe mbi numrin e studentëve që transferohen apo nuk e përfundojnë ciklin e dytë të studimeve. Këto të dhëna ruhen në hard copy dhe formë elektronike.</p> <p>Evid. 3. Rregullore UAMD</p> <p>Evidencë-47-Rregullore Sekretaria</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të</p>	<p>Të dhënat statistikore në lidhje me ecurinë e studentëve ruhen si në formën elektronike ashtu dhe në dosje fizike. Këto mbahen në Regjistrat bazë që ruhen në mënyrë të përhershme në përputhje me ligjin “Për Arkivat” dhe janë objekt kontrolli dhe</p>




<p>informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>në sistemin e menaxhimit të universitetit Pitagora që ofrohet nga RASH dhe garanton ruajtjen e konfidencialitetit dhe vërtetësinë e të dhënave. Sistemi Pitagora ka thjeshtuar mjaft punën si për personelin akademik ashtu dhe për sekretarinë, pasi të dhënat plotësohen elektronikisht nga pedagogu dhe aksesohen në kohë reale nga studentet në hapësirën e tyre personale brenda sistemit. Procesverbalet e detyrimeve dhe të provimeve të plotësuara elektronikisht në sistem, të printuara dhe firmosura nga pedagogu përgjegjës ruhen edhe në hard copy duke ofruar siguri të lartë. Ky sistem lejon përpunimin e thjeshtuar dhe në kohë më të shkurtër të të dhënave. Aksesimi i të dhënave statistikore brenda sistemit Pitagora realizohet konform të drejtave dhe roleve të përdoruesve sipas rregullores së UAMD dhe FE.</p> <p>Evidencë-5-Rregullore UAMD, Neni 83 dhe Neni 89.</p> <p>Evidencë-110-Ligji nr.9887 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njërive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Kontrolli periodik i përvitshëm për dokumentimin e saktësisë së informacionit që lidhet me studentët dhe veprimtarinë e tyre përkatëse është një procedurë e sanksionuar në rregulloren e FE. Në fund të çdo viti akademik, një komision ad hoc i ngritur nga departamentet kontrollojnë provimet dhe procesverbalet përkatëse për atë vit akademik. Në raste të identifikimit të parregullsive, përgjegjësi i departamentit i propozon dekanit masat e nevojshme për rregullimin e këtyre parregullsive sipas rastit.</p> <p>Evidencë-9-Rregullore FE, 2019</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Sipas DVV GVJ konstaon se DGjH analizon ecurinë e procesit mësimor. Analiza mësimore vjetore e departamentit në lidhje me programin MP“Mësues i Gjuhës Angleze” krahas të tjerash bazohet mbi raportet analitike të cilësisë në hyrje dhe dalje të studentëve si dhe shkallën e punësimit të tyre, të dhëna të ofruara nga sekretaria mësimore që aksesohen nga regjistri elektronik dhe Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës. Kjo analizë më pas vihet në dispozicion të FE, e cila e përshin në analizën vjetore të saj.</p>




	Evidencë-58-Mesatarja në Hyrje në UAMD, 2017-2018 vs. 2018-2019			
	Evidencë-72-Studentë të MP “Mësues i Gjuhës Angleze” të Punësuar			
	Evidencë-79-Analiza Vjetore e Njesisë Bazë në lidhje me MP “Mësues i Gjuhës Angleze”2021-2022.			
<b>Konkluzione</b>	<i>UAMD, nëpërmjet Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Lidhur me këtë standard, GVJ e konsideron atë të përmbushur plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	UAMD ka sanksionuar në rregulloret e miratuara të drejtën e studentëve që të përfaqësohen dhe të marrin pjesë në vendimarrje në të gjitha organet drejtuese të UAMD-së. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në Senatin Akademik të UAMD, në komisionet zgjedhore në nivel institucional dhe njësie kryesore si dhe në komisione të përhershme si NJBSC, Këshillin e Etikës etj.  Evidencë-3-Statuti UAMD-, Neni 79, 80, 88 dhe Neni 90 Evidencë-5-Rregullore UAMD, Kreu VI, Neni 115, Neni 21 Evidencë-9-Rregullore FE, 2019  Evidencë-12-Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, 2019.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e	Institucioni garanton pjesëmarrjen e studentëve në të gjitha vendimarrjet e UAMD-së, si në Senatin akademik të UAMD,






<p>studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Këshilli i etikës në UAMD, Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë në nivel institucion, Komisioni Institucional Zgjedhor – UAMD, Komisioni i zgjedhjeve të FE. Gjithashtu, studentët kanë të drejtë të japin vlerësimin e tyre në lidhje me cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të programit. Kjo realizohet përmes pyetësorëve që u shpërndahen nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë gjatë dy javeve të fundit të semestrit, e cila përpunon pyetësorët dhe nxjerr përfundimet në lidhje me këtë vlerësim. Rezultatet e anketimit nga studentët pasqyrohen në Raportin e Performancës së Personelit Akademik.</p> <p>Evidencë-5-Rregullore UAMD, Kreu VI, Neni 115.</p> <p>Evidencë-20- Rregullorja për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë</p> <p>Evidencë-21-Rezultatet nga Anketimi i Studentëve</p> <p>Evidencë-82-Formulari i Vlerësimit të Programit të Studimit</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Gjatë takimit në institucion GVJ konstatoi se në punën e vazhdueshme të departamentit për përditësimin e programeve lëndore dhe për mundësinë e përmirësimit të programeve të studimit merr parasysh sugjerimet dhe shqetësimet e studentëve. Mendimi i studentëve merret në konsideratë nëpërmjet pyetësorëve të shpërndarë nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës. Bazuar në vlerësimet të personelit akademik, përgjegjësit e njësive bazë analizojnë rezultatet e ankimimit dhe diskutojnë në departament problematikat e identifikuara për përmirësimin e tyre në të ardhmen. Nga ana tjetër, grupi përgjegjës për fushën e kërkimit në programin e studimit kontribuon në këtë drejtim duke marrë takime me studentët në lidhje me kurrikulën e programit, nisur nga nevojat e studentëve për t'u përshatur me tregun e punës.</p> <p>Evidencë-20- Rregullorja për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.</p> <p>Evidencë-21-Rezultatet nga Anketimi i Studentëve</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe</p>	<p>Rregullorja e UAMD u garanton studentëve të drejtën e shprehjes së mendimit mbi ndershmërinë e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve si dhe mundësinë e ankimimit të rezultatit. Pyetësorët semestralë mundësojnë studentin të shprehë mendimin e tij në lidhje me cilësinë e procesit mësimor.</p>

<p>kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Gjetjet nga përpunimi statistikor i pyetësorëve shërbejnë si bazë për përmirësimin e programit dhe për ndërmarrjen e plan veprimit nga ana e DGjH. Bazuar në takimin që GVJ pati me studentët, konstatohet që DGjH garanton transparencë në procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Studentët e konsideronin mënyrën e organizimit të vlerësimit të procesit mësimor si shumë efektive. Ata theksuan se procedura e njohjes me rezultatet e vlerësimitë shtë e drejta. Gjithashtu dhe në ato pak raste të ankimimit të rezultatit në ndonjë lëndë të caktuar mënyra e trajtimit të ankesës ishte shumë transparente dhe informuese. Si në të gjithë universitetin edhe në departamentin e Gjuhëve të Huaja në orën pas provimit të pjesshëm dhe në një orar i caktuar pas provimit final, studenti njihet me rezultatin dhe sigurohet për transparencën e vlerësimit duke marrë dhe sqarimet e duhura. Gjithashtu, Rregullorja u nje studentëve të drejtën të ankimojnë rezultatet sipas një procedure të caktuar tre ditë kalendarike pas publikimit të rezultateve. Në rast se pretendon shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit apo vlerësimit, studenti ia drejton ankesën Drejtuesit të Njësisë Kryesore. GVJ nuk shqyrtoi dokumente të tilla. Sepse nuk kishtë raste ankimi këtu periudhë.</p> <p>Evidencë-12-Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, 2019.</p> <p>Evidencë-15-Rregullore, Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2019</p> <p>Evidencë-21-Rezultatet nga Anketimi i Studentëve</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Nëpërmjet Rregullores dhe Statutit të UAMD-së sigurohet përfaqësim i studentëve në organet vendimarrëse dhe këshilluese. Gjithashtu ata përfshihen në vlerësimin për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të programit.</i></p> <p><i>Opinionet e tyre studentëve vlerësohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit akademik nga stafi akademik, titullarët e lëndëve, koordinatorët e programeve të studimit, përgjegjësit e departamenteve dhe reflektohet në përshtatjen e mësimdhënies, orareve mësimore, shpërndarjes së provimeve etj. Lidhur me këtë standard, GVJ e konsideron atë të përmbushur plotësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>




				X
--	--	--	--	---

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Institucioni ka procedura dhe njësi të posaçme me qëllim informimin dhe shërbimin e studentëve si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Sektorin e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, i cili është në shërbim të informimit dhe komunikimit të vazhdueshëm me studentët dhe me palë të treta. Studentët informohen me anë të postës elektronike, me informacione për ecurinë e tyre akademike dhe karrierën pas universitare;</li> <li>-Forma të ndryshme informimi janë panairi i punës, faqja ueb e UAMD dhe dhe rrejtet sociale Facebook dhe Instagram. Platforma Pitagora, Broshura, Guida e Studentit 22-23, fletëpalosje. Kë to janë një formë që kanë rritur edhe informimin e publikut dhe studentëve në lidhje me programet mësimore;</li> <li>-Sekretaria mësimore e FE u shërben studentëve në lidhje me procedurat e regjistrimit në fillim të semestrit dhe lëshimin e vërtetimeve të ndryshme që u nevojiten;</li> <li>-Përgjegjësi i Departamentit dhe stafi akademik i Departamentit ndihmojnë studentët përmes informimit dhe shërbimit të nevojshëm për mbarëvajtjen e studimeve dhe procesit mësimor;</li> </ul> <p>Evidencë-29-Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës</p> <p>Evidencë-47-Rregullore Sekretaria</p> <p>Evidencë-50-Numri i Personelit Ndihmës Akademik në Departament dhe Program</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe</p>	<p>GVJ konstaton se në zbatim të vendimit të rektoratit të UAMD për organizimin e tutorialit/mentorimit DGjH ka organizuar punën dhe ngarkon lektorët mentorues për të komunikuar me studentët në lidhje me problemet që mund të hasin gjatë viteve të studimit, si dhe për këshillim dhe mbështetje të tyre. Gjithashtu, Institucioni ka ngritur Zyrën e Komunikimit,</p>




<p>asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Alumnit dhe Karrieres e cila është përgjegjëse për komunikimin e vazhdueshëm me studentët duke i informuar lidhur me programin e studimit, drejton procesin e këshillimit të karrierës, ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mban kontakte me të diplomuarit dhe krijon Rrjetin Alumni.</p> <p>Evidencë-29-Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës</p> <p>Evidencë-34- Studentët e trajnuar nga Zyra e Karrierës</p> <p>Evidencë-65-Mbi Organizimin e Tutorialit/Mentorimit në UAMD.</p> <p>Evidencë-67-Ndarja e Mentorimit në Departament-Shembull</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>UAMD ka ngritur Zyrën e Këshillimit dhe Karrierës , e cila sipas rregullorese së Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, ofron shërbimin e këshillimit të karrierës për studentët. Kjo zyrë u ofron studentëve informacion në lidhje me realizimin e procesit mësimor, orientimin mbi praktikën profesionale si dhe këshillim karriere në lidhje me qasjen e tyre në tregun e punës duke i informuar mbi shkrimin e një CV-je, letrat e motivimit, si duhet të sillen gjatë një interviste pune etj.</p> <p>Evidencë-31-Takime Alumni UAMD</p> <p>Evidencë-33- Njoftime për punësim të studentëve dhe alumni</p> <p>Evidencë-34- Studentët e trajnuar nga Zyra e Karrierës</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Specialistët për këshillimin e karrierës dhe ALUMNI mbajnë kontakte të vazhdueshme me studentë edhe mbas diplomimit si informacion i nevojshëm për vlerësimin periodik të programeve të studimit të ofruara në UAMD. Drejtorja e Kurrikulave dhe Standarteve, në bazë të Rregullores për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, realizon periodikisht anketime të studentëve. Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës krijon databazën Alumni me të dhënat e studentëve në lidhje me punësimin e tyre. Kjo databazë rifreskohet vazhdimisht nga mbledhja e të dhënave të reja që mblidhen elektronikisht përmes një pyetësoi. Të dhënat</p>




	<p>nga databaza i vihen në dispozicion organeve drejtuese të UAMD. Vlen të theksohet që, GVJ vlerëson pozitivisht nismën e krijimit të Shoqatës Alumni, me objektiv mbështetjen e studentëve në drejtim të njoftimeve për punësim, shkëmbim përvojash, trajnime, seminare, ëorkshope etj.</p> <p>Evidencë-29-Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës.</p> <p>Evidencë-33- Njoftime për punësim të studentëve dhe Alumni</p> <p>Evidencë-72-Studentë të MP “Mësues i Gjuhës Angleze” të Punësuar</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Përsa i përket këtij standardi, GVJ e konsideron atë të përmbushur plotësisht. Institucioni ka procedura dhe njësi të posaçme me qëllim informimin dhe shërbimin e studentëve. Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës në UAMD, Sekretaria mësimore, Zyra e finances, Faqja ueb dhe rrjetet sociale, Ambientet e dedikuara për njoftime në fakultet, Koordinatorët e programeve të studimit, Përgjegjësi i departamentit dhe pedagogët janë disa nga mjetet apo njësitë e posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

### Standardi VI.1



<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>GVJ konstaton se UAMD ka hartuar politika dhe struktura të posaçme për monitorimin dhe vlerësimin periodik të aftësive mësimdhënëse dhe inovatore të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Në Statut parashikohen dispozita të veçanta për sa i përket sigurimit të cilësisë dhe garantimin e standardeve të kërkuara për mbarëvajtjen e procesit mësimor.</p> <p>Në UAMD funksionon Qendra për Edukim në Vazhdim e cila në bazë të rregullores së saj ka si detyrë hartimin e udhëzuesve për personelin akademik në lidhje me metodat e ndryshme dhe inovative të mësimdhënies dhe organizon përgjatë gjithë vitit akademik trajnime për personelin akademik në lidhje me metodat inovative në mësimdhënie si dhe për rritjen e aftësive pedagogjike të personelit akademik. Në takimin në institucion GVJ ata theksuan se një formë efektive për zhvillimin e tyre profesional është ndarja e përvojës së fituar nga vizitat në në universitete të vendeve të BE-së gjatë dhënjës së leksioneve të hapura. Me qëllim që procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies të realizohet në një formë më kuptimplotë e gjithashtu të bëhet tërheqës për studentët, lektorët kanë në dispozicion mjete audio vizuale si laptop-e, video – projektorë. Mësimdhënia me në qendër studentin është fokusi i orëve mësimorë në MP “Mësues i Gjuhës Angleze” ku lektori shërben si një urë lidhëse mes studentit dhe gjuhës e kulturës së huaj. Ky program studimi është në përmirësim të vazhdueshëm, siç përshkruhet edhe në planin strategjik të paraqitur.</p> <p>Evidencë-3-Statuti UAMD, Kreu VII, Neni 77</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit</p>	<p>Cilësia e mësimdhënies dhe performanca e stafit akademik vlerësohet në mënyrë periodike të vazhdueshme nga strukturat dhe mekanizma që bazohen në nenin 2 dhe 10 të Rregullores së NJSBC, neni 80 i Statutit të Ri UAMD. Ky vlerësim kryhet përmes plotësimit nga ana e stafit akademik të formularit të vetëvlerësimit, ku raportohet mbi arritjet shkencore të tyre gjatë vitit të fundit. Artikujt apo publikimet shkencore paraqiten sërish në formularin e kërkimit shkencor. Gjithashtu performanca e stafit akademik vlerësohet edhe përmes pyetësorëve të</p>

<p>akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>plotësuara nga studentët. Zyra e Degës Mësimore monitoron prezencën e lektorëve në auditorë.</p> <p>Evidencë-22-Politika dhe Strategjia e Sigurimit të Cilësisë së Brendshme, FE.</p> <p>Evidencë-23-Raporti i Vlerësimit të Cilësisë së Brendshme FE.</p> <p>Evidencë-25-Ngritja e Komisionit të Vlerësimit të Brendshëm të FE-së.</p> <p>Evidencë-84-Urdhri i Rektoratit mbi Transparencën e Marrëdhënies Student-Pedagog.</p> <p>Evidencë-90-Baza e Kërkimit Shkencor në Njësinë Bazë</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Studentë janë përfshirë në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve në mënyrë anonime rreth mënyrës së zhvillimit të orës mësimore për çdo lektor. Plotësimi i pyetësorëve zhvillohet dy herë gjatë vitit akademik, në të dy semestrat bazuar në nenin 6 të Rregullores së NJSBC.</p> <p>Evidencë-83-Formulari i Vlerësimit të Stafit Akademik nga Studentët</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Rezultatet dhe analizat e pyetësoreve i vihen në dispozicion individualisht me email, të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, përgjegjësve të departamenteve, si dhe dekanëve përkatës nga Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë në Rektorat. Njësia bazë diskuton me çdo lektor rreth mundësive për të përmirësuar pikat ku vlerësimi i studentëve ka qenë i ulët dhe bazon vlerësimin vjetor të çdo lektori mbi këto të dhëna. Departamenti i Gjuhëve të Huaja, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit “Mësues i Gjuhës Angleze”, bën publike rezultatet e vlerësimit nëpërmjet analizës vjetore të njësisë bazë.</p> <p>Evidencë-5-Rregullore UAMD, Neni 69</p> <p>Evidencë-20- Rregullorja për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë</p> <p>Evidencë-68-Rezultatet e Vlerësimit të Stafit Akademik, 2018-2019</p>
	<p>Evidencë-81-Kriteret e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore shkencore</p>

	Evidencë-92-Raporti mbi Veprimtarinë Mësimore-Shkencore të Departamentit, 2021-2022.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<p>UAMD dhe FE promovon shembuj të praktikave më të mira, si dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien, duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe seminare me profesorë të ftuar nga universitete të huaja, zgjerimin e rrjeteve të bashkëpunimeve dhe angazhimeve në në projektet e financuara nga BE (ERASMUS+). GVJ konstaton se si pjesë përbërëse e institucionit DGjH veçon dhe promovon praktikat më frytdhënëse të lektorëve në auditor duke synuar rritjen dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Rezultatet e marra nga pyetësorët e plotësuar nga studentët si dhe formularët mbi arritjet shkencore të lektorëve kanë shërbyer si shtysë për përmirësimin jo vetëm të cilësisë së mësimdhënies, por edhe të arritjeve shkencore të stafit akademik.</p> <p>Evidencë-26- Plani i Zhvillimit Strategjik i Programit MP “Mësues i Gjuhës Angleze”.</p> <p>Evidencë-78- Mobilitete të Stafit Akademik FE</p> <p>Evidencë-83-Formulari i Vlerësimit të Stafit Akademik nga Studentët</p> <p>Evidencë-94- Formulari i Vetëvlerësimit të Personelit Akademik</p> <p>Evidencë-93-Raporti i Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore të Departamentit, 2019-2020</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Institucioni ka ngritur struktura dhe ka miratuar udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie në UAMD sigurohet nëpërmjet: pyetësorit të studentit, formulari i vetëvlerësimit të pedagogëve dhe vlerësimit të përgjegjës të departamentit për çdo anëtar të stafit. Rezultatet dhe analizat e pyetësoreve i vihen në dispozicion individualisht të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, përgjegjësve të departamenteve, si dhe dekanëve dhe problematikave dhe plani i masave diskutohet deri në nivel departamenti. Lidhur me këtë standard, GVJ e konsideron atë të përmbushur plotësisht.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht




				X
--	--	--	--	---

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV dhe takimi me përfaqësues nga Drejtoria e Kurrikulave &amp; Standarteve të Cilësisë, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar politika dhe struktura të posaçme për sigurimin e brendshëm të cilësisë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. Njësia përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë në UAMD është Drejtoria e Kurrikulave &amp; Standarteve të Cilësisë e cila funksionon mbi bazen e Rregullores së Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. Në nivel fakulteti funksionojnë Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program studimi, Koordinatorët e Programeve. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë është struktura mbikëqyrëse, vlerësuese, miratuese dhe garantuese e standardeve të cilësisë së institucionit dhe e programeve të studimit.</p> <p>Evidencë-3-Statuti UAMD, Kreu VII</p> <p>Evidencë-20- Rregullore për Sigurimin e Cilesise, Neni 8-9.</p> <p>Evidencë-24-Vendim Dekanati për krijimin e GVB-ve mbi Akreditimin e Programeve të studimit në FE</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe në vizitën në institucion GVJ konstaton se UAMD ka ngritur Komisionin i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë që është struktura mbikëqyrëse, vlerësuese, miratuese dhe garantuese e standardeve të cilësisë së institucionit dhe e programeve të studimit. Ka përfaqësues nga secila Njësi Kryesore e UAMD-së, përfshirë edhe një student. Funksionimi i këtij komisioni bazohet në rregulloren përkatëse. Gjithashtu funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë me 7 anëtarë, nga të cilët, një përfaqësues nga stafi akademik i çdo fakulteti të UAMD-së,</p>




<p>bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>drejtuesi i Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë në Rektorat, dhe një përfaqësues nga studentët. Kjo njësi realizon raporte periodike të vetëvlerësimit në bashkëveprim me Njesitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel fakulteti. Në kuadër të vlerësimit të brendshëm, GVJ konstaton se GVB për programin MP në Mësuesi është ngritur në përputhje me Statutin e UAMD në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së FE dhe të UAMD-së ka hartuar Raportin e Vetvlerësimit në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore, dhe të bazuar në dokumentat.</p> <p>Evidencë-4-Plani i Zhvillimit Strategjik UAMD, 2020-2025</p> <p>Evidencë -20-Rregullorja per Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit te Brendshem te Sigurimit te Cilesise.pdf</p> <p>Evidencë-94-Formulari i Vlerësimit të Stafit Akademik nga Studentët.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>UAMD përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. UAMD i është nënshtruar procesit të Akreditimit Institucional në vitin 2016 dhe është akredituar për 4 vite akademike në përfundim të procesit të akreditimit. Një proces vlerësimi dhe akreditimi institucional u realizua gjatë vitit 2021 ku UAMD u vlerësua me Veendim BA Nr.18, nga data 24.03.2022 deri në 23/03/2026. Programi MP “Mësues i Gjuhës Angleze” nuk i është nënshtruar asnjë akreditimi të mëparshëm.</p> <p>Evidencë-76Vendimi i Bordit të Akreditimit për UAMD, 2017</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime</p>	<p>Bazuar në DVV dhe në takimet me stafin akademik, GVB dhe me përfaqësues nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, GVJ gjykon që institucioni dhe FE përdorin tregues të qartë dhe të matshëm për të pasqyruar gjendjen, arritjet dhe dobësitë, dhe për të bërë promovime nxitëse. Ky proces i brendshëm i sigurimit të cilësisë përfshin aktivitete të rregulla monitoruese dhe përmirësuese që kryhen duke përdorur instrumentat e brendshëm të saj për sigurimin e cilësisë. Mbi bazën e të dhënave bëhen analizat ku evidentojnë arritjet në procesin mësimor dhe kërkimor e shkencor dhe problematikat, diskutohen me palët</p>






<p>nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>përkatëse dhe në bazë të tyre nxirren rekomandimet që kanë si qëllim të adresojnë problematikat dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre, sin ë bazë institucioni ashtu edhe të Njesisë kryesore dhe bazë.</p> <p>Evidencë-8-Raporti Vjetor UAMD</p> <p>Evidencë-79-Analiza Vjetore e Njesisë Bazë në lidhje me MP “Mësues i Gjuhës Angleze”2021-2022.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Për sa më sipër, GVJ e konsideron kë të standard të përmbushur plotësisht. UAMD ka ngritur struktura në nivel institucional dhe Njësi kryesore për sigurimin e cilësisë. NjBSC-ja ka si mision parësor përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në UAMD duke përfshirë të gjithë aktorët e angazhuar në këtë proces të vazhdueshëm studentët, bashkëpunimi me ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Këto struktura funksionojnë sipas rregulloreve të brendshme institucionale.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi VI.3**

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentave në DVV GVJ konstaton se UAMD, mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore, si edhe me politikat për sigurimin e brendshëm të cilësisë ka përcaktuar hapat që duhen ndjekur për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të ciklit të dytë.</p> <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë kryen në mënyrë periodike vlerësimin e programit të studimit. Pyetësorët e ndërtuar kanë për qëllim vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të institucionit. Zyra e Alumnit dhe Karrierës harton pyetësorë për punësimin e studentëve si dhe paraqet statistikën në lidhje me ngarkesën mësimore të stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm,</p>




<p>planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>numrin e studentëve të regjistruar, numrin e studentëve të çregjistruar, numrin e studentëve të diplomuar me, personelin akademik dhe administrativ, numrin e studentëve që përfitojnë bursë. Këto vlerësime dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse të cilët në varësi të problematikave marrin masa për përmirësimin e treguesve.</p> <p>DGjH nëpërmjet proceseve të dokumentuara ka bërë shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrje të vazhdueshme të programit të ciklit të dytë. DGjH ka hartuar dhe implementon strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë përmes mbledhjeve të hapura me stafin dhe studentët e Masterit Profesional. Në vitin akademik 2018-2019 hyri në veprim kurrikula e përmirësuar në përputhje me ligjin e ri të arsimit. Analiza vjetore mbi ecurinë e programit, krahasimi i mesatares në hyrje të studentëve në program dhe në dalje, trendi i interesimit të studentëve për programin janë referencë e dokumentuar e punës së njësisë bazë në lidhje me programin.</p> <p>Evidencë-4-Plani i Zhvillimit Strategjik UAMD, 2020-2025</p> <p>Evidencë-20- Rregullore per Sigurimin e Cilesise, Neni 6, 12.</p> <p>Evidencë-93-Raporti i Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore të Departamentit, 2021-2022</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se UAMD çdo vit harton raporte përmbledhëse të veprimtarisë institucionale ku përfshihet procesi mësimor dhe analiza e kërkimit shkencor me të gjithë elementët e saj, ku jepen rekomandime për rritjen e cilësisë në UAMD. Po kështu departamenti i Gjuhëve të Huaja harton në mënyrë të përvitshme një analizë të punës mësimore kërkimore, pjesë e së cilës është analiza e ecurisë në programin Master, ku përfshihen arritjet, mangësitë dhe sugjerimet përkatëse për t'i kapërcyer ato në mënyrë që të përmbushet cilësia e programit. Këto raporte janë të përvitshme dhe në to publikohen rezultatet e vlerësimit.</p> <p>Programi i studimit MP “Mësues i Gjuhës Angleze” nuk i është nënshtruar më parë procesit të akreditimit. Referuar RVB nga Departamenti çdo shtator bëhet analiza vjetore e procesit mësimor dhe kërkimor e kësaj programi, tek e cila paraqiten problematikat e vitit që ka përfunduar dhe objektivat që duhet të arrihen. Kjo analizë shoqërohet edhe me një plan masash që adresojnë problematikat e evidentuara.</p>




	<p>Evidencë-15-Rregullore, Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2019.</p> <p>Evidencë-20- Rregullore per Sigurimin e Cilesise, Neni 16.</p> <p>Evidencë-79-Analiza Vjetore e Njesisë Bazë në lidhje me MP “Mësues i Gjuhës Angleze”2021-2022</p> <p>Evidencë-90-Baza e Kërkimit Shkencor në Njësinë Bazë.</p> <p>Evidencë-92-Raporti mbi Veprimtarinë Mësimore-Shkencore të Departamentit, 2021-2022.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>UAMD duke u bazuar në rregulloren e miratuar, përdor metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit. Cilësia e programit të studimit Master Profesional kontrollohet dhe monitorohet drejtpërdrejt nga drejtuesja e departamentit, e cila është edhe koordinatore etij. Në zbatim të rregullores së FE ajo mbikqyr respektimin e programeve, cilësinë e mësimdhënies, disiplinën në punë dhe realizon analizat periodike të ecurisë së programit.</p> <p>ZV dekani i anës mësimore mbikqyr përgatitjen dhe zbatimin e planeve e programeve mësimore dhe të orarit mësimor si zhvillimin e aktiviteteve didaktike konform strukturës mësimore dhe orarit mësimor të miratuar. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nga njësia bazë realizohet duke përdorur raportet e hartuara nga stafi akademik në lidhje me mësimdhënien, të dhënat e ofruara nga sekretaria mësimore, monitorimi i realizimit të aktiviteteve të programit të studimit, opinionin e studentëve dhe personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie etj.</p> <p>Evidencë-20- Rregullorja për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë,Neni 3.</p> <p>Evidencë-68-Rezultatet e Vlerësimit të Stafit Akademik, 2018-2019</p> <p>Evidencë-82-Formulari i Vlerësimit të Programit të Studimit</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e</p>	<p>GVJ konstaton se UAMD përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi për mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit. Janë realizuar pyetësorë nga Drejtorja e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë që kanë për qëllim tërheqjen e mendimit të studentëve për aspekte të programit të studimit dhe përmirësimit të tij. UAMD në bashkëpunim me Qendrën e Karrierës dhe Alumni, ka organizuar pyetësorë të</p>

<p>intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademi e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>vazhdueshëm që kanë si qëllim gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet dhe për të analizuar performancën dhe nivelin e kompetencave të studentëve që kanë mbaruar program studimi në përputhje me vendin e punës. Organizohen panire pune ku mbledhen sugjerimet dhe kërkesat e tregut të punës në lidhje me programet e studimeve</p> <p>Evidencë-44-Studimi i tregut të punës pas Diplomimit të Studentëve, Shtator 2020.</p> <p>Evidencë-68-Rezultatet e Vlerësimit të Stafit Akademik, 2018-2019.</p> <p>Evidencë-82-Formulari i Vlerësimit të Programit të Studimit.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Lidhur me këtë standard, GVJ e konsideron atë të përmbushur plotësisht. UAMD monitoron dhe vlerëson përmes njërive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëniet duke përdorur metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit.</i></p> <p><i>DGjH nëpërmjet proceseve të dokumentuara ka bërë shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrje të vazhdueshme të programit të ciklit të dytë. DGjH ka hartuar dhe implementon strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi VI.4**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të</p>	<p>Mbështetur në DVV dhe vizitat në institucion GVJ konstaton se UAMD ka parashikuar dhe garanton që të përfshihen aktorë të brendshëm e të jashtëm në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. Aktorët e përfshirë janë në nivel Institucional (Senati</p>






<p>cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Akademik, Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë Koordinatori Institucional pranë ASCAL, Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë).</p> <p>Në nivel Fakulteti janë Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program, Koordinatorët e Programeve. Përfaqësues nga studentët sipas Statutit dhe rregulloreve përkatëse. Studentët janë të përfaqësuar në çdo organ kolegjal duke filluar nga Senati Akademik, Bordi i Administrimit NJSC Studentët marrin pjesë në mbledhjet e Dekanatit dhe departamentit kur trajtohen çështje që kanë lidhje me ta. GVJ konstaton që institucioni parashikon dhe garanton përfshirjen në vlerësimin e brendshëm të aktorëve të brendshëm stafit akademik, stafit joakademik, studentët dhe grupet e interesit të lidhura me programin e studimit apo institucionit. Në takimin me GVB përfaqësuesi i studentëve ishte pjesë aktive e diskutimeve.</p> <p>Evidencë-5-Rregullore UAMD</p> <p>Evidencë-9-Rregullore FE</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitet, individët, studentët dhe palët të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në rregulloren e Sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e aktorëve kryesorë si njësitet, studentët, palët e tjera të angazhuara në sigurimin e cilësisë së programit. Rregulloret e posaçme kanë të përcaktuar qartë detyrat konkrete që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë, si kontrolli i vazhdueshëm i kurrikulave, syllabuseve, organizimi i pjesëmarrjeve në orë leksionesh të hapura apo ftesa ndaj lektorëve të jashtëm me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p>Evidencë-15-Rregullore, Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2019</p> <p>Evidencë-20-Rregullore për Sigurimin e Cilësisë, Neni 3</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të</p>	<p>UAMD garanton që në procedurat e sigurimit të cilësisë të të përfshihen të gjithë aktorët e interesuar. Për vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së këtij PS janë përfshirë staf akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe studentë. GVJ, gjate vizitës në Institucion, konstaton se ka një bashkërendim të mirë pune midis njësive bazë, njësive kryesore dhe stukturave përgjegjëse në Institucion. Antaret e personelit akademik janë njohur me</p>



<p>personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>draftin e raportit të GVB dhe kanë kontribuar sipas kërkesave nga antarët e GBV të programit. Si personeli, ashtu edhe antarët e GVJ kanë njohuri të plotë të detyrave, të drejtave dhe objektivave si departament.</p> <p>Evidencë-3-Statuti UAMD, 2018, kreu VII, Neni 77/78 dhe 80.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se ngritja e grupeve të vlerësimit të brendshëm është bërë duke respektuar integritetin akademik të pjesmarrësve që janë përfaqësuar në mënyrë jo diskriminuese. Vlerësimi është gjithëpërfshirës, duke bërë pjesë të procesit vetëvlerësimit nga ana e pedagogut, vlerësimit nga eprorët dhe nga studentët.</p> <p>Evidenca-24-Vendim Dekanati për krijimin e GVB-ve mbi Akreditimin e Programeve në FE.pdf</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Gjatë takimeve në institucion GVJ u informua se UAMD përfshin ekspertë nga tregu i punës në vlerësimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë. FE dhe DGjHtë Huaja konsultohen në mënyrë të vazhdueshme me aktorë të jashtëm dhe palë të treta:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- gjatë organizimit të takimeve apo konferencave me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”</li> <li>- bashkëpunimi me institucionet arsimore ky kryhet praktika profesionale</li> <li>-gjatë krahasimit të planit mësimor të Master në mësuesi për përafrimin e tyre në masën 80% me IAL që përgatisin mësues.</li> </ul> <p>GVJ vlerëson se DGjH si njësi bazë përgjegjëse për këtë program studimi në mënyrë të vazhdueshme rishikon dhe përmirëson planin mësimor nisur nga nevojat e tregut dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>Evidencë-2-Strategjia e Ndërkombëtarizimit të UAMD</p> <p>Evidencë-43- Marrëveshjet e bashkëpunimit UAMD me Erasmus</p> <p>Evidencë-66-Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD-ës</p> <p>Evidencë-77-Marrëveshje Bashkëpunimi me DAR</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Lidhur me këtë standard, GVJ e konsideron atë të përmbushur plotësisht. UAMD përfshin njësitë akademike, personelin</i></p>

	<i>akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe garanton që procedurat e sigurimit të cilësisë të demonstrojnë transparencë dhe përgjegjësi për të gjithë aktorët e saj. Të gjitha strukturat e institucionit bashkëveprojnë dhe sigurojnë një shërbim cilësor në nxitjen dhe rritjen e cilësisë në të gjitha nivelet.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ ka në dispozicion të gjithë dokumentat që paraqesin politikat, strategjitë dhe veprimtaritë në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për këtë program studimi. Rregullorja e UAMD, Rregullorja e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë, Plani Strategjik, kalendari akademik, Raportet e përvitshme vjetore dhe të gjitha vendimet e Senatit afishohen në faqen zyrtare të <a href="http://eëë.uamd.edu.al">eëë.uamd.edu.al</a> , ndërsa vendimet në nivel rektorati apo dekanati shpërndahen përmes postës elektronike drejt asambleve përkatëse. Vlerësimi të cilësisë së programit të studimit (shpërndarja e pyetësorëve, përpunimi i tyre, marrja e rezultateve) është transparent dhe u komunikohen individualisht studenteve dhe të gjithë aktorëve në tjerë. <a href="https://uamd.edu.al/">https://uamd.edu.al/</a>  Evidencë-117-Politika dhe Strategjia e Komunikimit dhe Marketimit të Institucionit.  Evidencë-111-Të Dhëna nga Ëëbsite-i i UAMD-së.  Evidencë-109-Programi i Transparencës UAMD
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën	GVJ konstaton që procesi i vlerësimit të cilësisë në programin e studimit karakterizohet nga transparenca dhe ruajtja e konfidencialitetit. NjSBC në nivel institucional publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, dhe gjithë informacioni që disponohet për këtë qëllim, publikohet në

<p>akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>dokumentacionet përkatëse apo online duke respektuar lirinë dhe etikën akademike si dhe legjislacionin për të dhënat personale për të gjithë individët e përfshirë në këtë proces.</p> <p>Të gjitha të dhënat në UAMD përpunohen dhe bëhen publike duke zbatuar Kodin e Etikes për Konfidencialitetin e të dhënave personale. Programi i transparencës në UAMD, i cili i shërben rritjes së transparencës, integritetit dhe përgjegjshmërisë institucionale të universitetit, është përgatitur në përputhje me nenin 7 të ligjit 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe garanton rregullat bazë të organizimit dhe funksionimit në përputhje me legjislacionin e arsimit të lartë.</p> <p>Evidencë-89-Raport mbi Aktivitetin Kërkimor-Shkencor AMD, 2018-2019</p> <p>Evidencë-110-Ligji nr.9887 për Mbrojtjen e të Dhënave personale.</p> <p>Evidencë-117-Politika dhe Strategjia e Komunikimit dhe Marketimit të Institucionit</p> <p>Evidencë-119-Booklet UAMD</p> <p>Evidencë-120-Broshura Para Promovimit</p> <p>Evidencë-121-Broshura pas Promovimit</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Bazuar në analizën e arritjeve DGjH ka adresuar problemet e evidentuara duke i bërë objekt diskutimi në department. Gjatë takimit në insitucion GVJ u informua se çdo shtator nga Përgjegjësi i Njësisë Bazë bëhet analiza vjetore e procesit mësimor dhe kërkimor, tek e cila paraqiten problematikat e vitit që ka përfunduar dhe objektivat që duhet të arrihen. Kjo analizë shoqërohet edhe me një plan masash që adresojnë problematikat e evidentuara. Për përmirësimin e planit mesimor, departamenti propozon ndryshimet e nevojshme në programin e studimit apo në elementët përbërës të tij nisur nga nevojat e identifikuar për përditë sim, përpara fillimit të vitit akademik pasardhës.</p> <p>Evidencë-15-Rregullore, Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2019.</p> <p>Evidencë-79-Analiza Vjetore e Njësisë Bazë në lidhje me MP “Mësues i Gjuhës Angleze”2021-2022.</p>

	Evidencë-92-Raporti mbi Veprimtarinë Mësimore-Shkencore të Departamentit, 2021-2022.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së UAMD ka ngritur komisione të posaçme. Funkcionimi i Komisioneve bazohet në Statutin e UAMD-së, në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Komisionet koordinojnë, përpilojnë dhe raportojnë aktivitete dhe iniciativa të reja lidhur me sigurimin e cilësisë në të gjitha njësitë e UAMD nëpërmjet Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Koordinatorit Institucional. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë që funksionon në FE ka në përbërjen e saj një staf akademik të konsoliduar dhe perfaqësues nga studentët.  Evidencë-20-Rregullorja për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	UAMD në mënyrë konstante analizon dhe informon asamblenë akademike të institucionit për çështje që kanë të bëjnë me të gjithë veprimtarinë e IAL-së, ku një vend të rëndësishëm zë cilësia e programeve të studimit. Raporti vjetor i UAMD-së publikohet në faqen e ëbsite të UAMD-së, me qëllim rritjen e transparencës për këtë proces të rëndësishëm të universitetit, por edhe për të ndërgjegjësuar studentët dhe personelin akademik për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimit afatgjatë të saj në programin e studimit. UAMD përfshin të gjitha organet e brendshme në trajnime periodike me qëllim sigurimin e cilësisë dhe rritjen e kapaciteteve njerezore dhe shërbimeve të ofruara nga institucioni. Bazuar në rregulloren e brendshme dhe institucionale, FE ka caktuar një Koordinator për çdo program studimi që ofron i cili është pjesë e grupit të punës për hartimin e kurrikulës. Departamenti i Gjuhëve të Huaja gjithashtu organizon veprimtari informuese me studentët e secilit cikël të studimeve dhe garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programit të studimit MP në "Mësues i Gjuhës Angleze"  Evidencë-89-Raport mbi Aktivitetin Kërkimor-Shkencor UAMD, 2018-2019  Evidencë-115-Raporti i Veprimtarisë Audituese, 2020-2021  Evidencë-109-Programi i Transparencës UAMD
<b>Konkluzione</b>	<i>Lidhur me këtë standard, GVJ e konsideron atë të përmbushur plotësisht. Institucioni ka krijuar Kulturën e Brendshme të</i>




	<p><i>Cilësisë. Kjo duket në rregulloret e institucionit të bëra publike dhe transparente për të gjitha politikat, strategjitë, mënyrën e organizimit dhe veprimtaritë e ndërmarra në kuadër të Sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programet e studimit dhe në përfshirjen e të gjithë aktirëve të interesuar.</i></p> <p><i>Informimi e ndërgjegjësimi i personalit akademik dhe studentëve për këtë proces ka ndikuar në sigurimin e përmisimit të vazhdueshëm të cilësisë.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në: “Mësues i Gjuhës Angleze”**

**a. Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Programi i studimit MP në Mësues i Gjuhës Angleze është hartuar në përputhje me vizionin, misionin e Institucionit dhe nevojave të tregut dhe në përputhje me objektivat dhe profilin e përcaktuar;
2. Programi ka riorganizuar kurrikulën e vet sipas legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tregut, gjë që mundëson studentët të pajisen me njohuritë e aftësi të qëndrueshme në fushën e tyre të studimit si dhe të pozicionohen më lehtë në tregun e punës;
3. Programi zhvillohet në gjuhën angleze, që lehtëson ofrimin dhe shfrytëzimin e literaturës të përditësuar. Bashkëpunimi me biblioteka on line jashtë vendit është ndihmesë në këtë drejtim;
4. Stafi akademik ka formim në mësimdhënie dhe eksperiencë ndërkombëtare dhe punon në mënyrë të vazhdueshme që të zhvillohet profesionalisht, nëpërmjet trajnimeve, programeve të mobilitetit dhe pjesëmarrjes në kërkimin shkencor dhe vetëvlerësimit;






5. Ndjekja rigoroze e praktikës profesionale dhe asistenca profesionale e ofruar nga stafi i programit dhe institucionet bashkë punuese arsimore i pajisin studentët më kompetenca në fushën e mësuesisë duke u mundësuar atyre punësim dhe zhvillim të mëtejshëm në karrierë;
6. Godina nr.1, në kampusin e ri, ku gjendet Departamenti i Gjuhëve të Huaja ofron kushte infrastrukturore optimale duke lehtësuar mbarëvajtjen e një procesi normal mësimor;
7. Administrimi online i të dhënave nga njësia kryesore ka rritur cilësinë e shërbimeve dhe transparencën ndaj studentëve;
8. Sistemi i bursave të ofruara për studentët cilësorë dhe ata në nevojë nga vetë institucioni e bëjnë këtë program të kërkuar dhe të dëshiruar për një masë të madhe studentësh;

#### **b. Pika të dobëta:**

1. Mungesa e pajisjeve mbështetëse si p.sh, video projektor ose smartboard në të gjitha auditorët krijon vështirësi si për studentët ashtu edhe për lektorët; *(Standardi IV.2, kriteri 2)*
2. Numër i ulët i përfshirjes së studentëve në mobilitete; *(Standardi II.6, kriteri 3)*
3. Mungesë e librave fizikë për lëndët e programit të studimit në Bibliotekë; *(Standardi IV.3 kriteri 4)*
4. Numër i ulët i orëve të praktikës që zhvillohen në institucionet arsimore, Institucioni t'ju mundësojë studentëve më shumë ore praktike në shkolla gjatë kryerjes së praktikës profesionale; *(Standardi II.1 kriteri 3)*

#### **c. Rekomandime**

1. GVJ rekomandon që mjediset mësimore të pajisen me mjete audiovizuale, për të lehtësuar zhvillimin e mësimin në auditor. Vetëm dy laboratorë, nga donacione të huaja funksionojnë, por nuk mund të jenë të përdorshëm nga të gjithë studentët;
2. GVJ rekomandon që departamenti të nxisë më shumë studentët për të përfituar nga programet Erasmus+;
3. GVJ rekomandon që biblioteka e Fakultetit duhet të ketë më shumë fonde fizike, sepse numri i librave fizik në dispozicion të studentëve për lëndët e këtij programi ishte minimal;
4. GVJ rekomandon që të rishikohet raporti i orëve të praktikës që zhvillohen në auditor me orët në institucionet arsimore, duke ju mundësuar studentëve më shumë orë praktike në shkolla gjatë kryerjes së praktikës profesionale;
5. GVJ rekomandon se duhet të bëhet një kombinimi i vlerësimit me gojë dhe me shkrim, për vetë specifikën e programit, mund t'i lihet më shumë vend në vlerësim, vlerësimit të aftësive komunikative, jo vetëm 10 %, si parashikohet deri tani;
6. GVJ rekomandon që raporti leksion seminar duhet të ndryshojë në disa lëndë, të cilat të kenë më shumë orë seminaresh për të vënë theksin dhe zhvilluar aftësitë gjuhësore të studentëve,

lëndë si: “Standard i shkrimit në gjuhën Angleze”; “Zhanri letrar në mësimdhënien e gjuhës angleze”; “Mësimdhënia nëpërmjet kontekstit historik (ANG)”; “Gramatikë e Avancuar e gjuhës Angleze”;

## **Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program Professional Master in "English Language Teacher"**

### **a. Strengths and affirmations:**

1. The study program Professional Master in “Teacher of English Language” is a program designed in accordance with the vision, mission of the Institution and labor market needs and all in line with its objectives and profile;
2. The program has reorganized its curriculum according to the legislation in force and in accordance with the needs and demands of the market, which enables students to be equipped with steady knowledge and skills in their field of study as well as allowing to fit in more easily in the labor market;
3. The program is taught in English, which facilitates the provision and use of updated literature. Cooperation with online libraries abroad is helpful in this regard;
4. The academic staff has training in teaching and international experience and works continuously to develop professionally, through training, mobility programs, and participation in research and self-assessment;
5. The rigorous supervision of the professional practice and the professional guide provided by the academic personnel and the cooperating educational institutions of the region equip students with competencies in the field of teaching, enabling them to be employed and further develop in their careers;
6. Building No. 1, on the new campus, where the Department of Foreign Languages is located, offers optimal infrastructural conditions facilitating the smooth running of a normal teaching process;
7. Online data administration by the main unit has increased the quality of services and transparency to students;
8. The system of scholarships offered to quality students and those in need by the institution make this program sought after and desired by a large number of students;

### **b. Weak points:**

1. The lack of supportive equipment such as, for example, video projectors or smartboards in all auditoriums creates difficulties for both students and lecturers; (*Standard IV.2, criterion 2*)
2. Low number of student involvement in mobilities; (*Standard II.6, criterion 3*)
3. Absence of physical books for subjects of the study program in the library; (*Standard IV.3 criterion 4*)
4. Low number of practice hours that take place in educational institutions, the Institution should enable students to have more practice hours in schools during the professional practice; (*Standard II.1 criterion 3*)

### Recommendations

1. GVJ recommends that learning environments be equipped with audiovisual tools to facilitate the development of learning in the auditorium. Only two laboratories, from foreign donations, are functioning, but they cannot be used by all students;
2. GVJ recommends that the department encourage more students to benefit from Erasmus+ programs;
3. GVJ recommends that the faculty library should have more physical funds, because the number of physical books available to students for the subjects of this program was minimal;
4. GVJ recommends to revise the ratio of practice hours that take place in the auditorium with hours in educational institutions, enabling students to have more practice hours in schools during professional practice;
5. GVJ recommends that a combination of oral and written evaluation should be done, for the very specificity of the program, more space can be left in the evaluation, the evaluation of communication skills, not only 10%, as foreseen until now;
6. GVJ recommends that the lecture-seminar ratio should change in some subjects, which have more seminar hours to emphasize and develop students' language skills, subjects such as: "Standard of writing in the English language"; "Literary genre in English language teaching"; "Teaching through historical context (ANG)"; "Advanced English Grammar";




**Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË</b>				X
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				X
<b>IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				X
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				X